

**27.05.2021  
Ora 10:09**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 39, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe nr. 51, datë 10.05.2021 të subjektit ankues Boiken Abazi, kandidat i mbështetur nga zgjedhësit, për zonën zgjedhore qarku Tiranë”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD-AN, LSI, PS

**Z. L. Braho:** Mirëmëngjes të gjithëve! Riçelim seancën e shqytitimit administrativ për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 39 dhe 51. Kërkesat ankimore depozituara respektivisht nga subjektet zgjedhore koalicioni PD-AN dhe kandidati i propozuar nga një numër zgjedhësish zoti Bojken Abazi. Po ashtu si subjekt interesuar është edhe subjekti zgjedhor LSI dhe Partia Socialiste e Shqipërisë. Para se të vijojmë me procedurën kemi një zevendësues të subjektit zgjedhor Partia Socialiste për Integrim. Zoti Merkaj!

**Z.Y. Merkaj:** Po në vend të përfaqësuesit të përfaqësuesit zotit Kreshnik është zonja Silca Caka.

**Z. L. Braho:** Në rregull faleminderit! Zonja Silva Caka është e pranishme. Ndërkohë përfaqësuesi i Partisë Socialiste është njoftuar?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z.Y. Merkaj:** Po!

**Z. L. Braho:** Do vijojmë në mungesë, mbase vjen më vonë. Atëherë, seancën e kaluar që kemi zhvilluar për shqyrtimin administrativ në lidhje me këto ankime që i përkasin Qarkut Tiranë. Kemi kryer paraqitjen e pretendimeve edhe kërkimin e provave. U pranuan provat që ishin depozituar nga palët, po ashtu u bë edhe kërkesa nga dy anëtarë të KAS për dy prova të reja. Njëra ishte që kishte të bënte me filmimet e një QV nga ora 18:50 e në vijim. Kërkesë që u bë nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit dhe më tej u mbështet nga dy anëtarë të KAS. Po ashtu edhe kryqëzimin e të dhënave e pajisjeve PEI për Qarkun e Tiranës. Kërkesë që u bë nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike dhe po ashtu u mbështet nga dy anëtarë të KAS. Administrata zgjedhore i ka gati këto prova? Në qoftë se i ka gati, të na njoftojë dhe kur ia ka vënë në dijeni subjekteve dhe më tej subjektet të na thonë në qoftë se janë njojur me to? Dhe në qoftë se ka ndonjë pretendim lidhur me këto prova.

**Z.Y. Merkaj:** Në lidhje me pamjet filmike i kemi dhënë që pardje personit të interesuar, ankuesit. Kurse për kryqëzimin e të dhënave ia kemi dhënë dje tre përfaqësuesve të partive politike PD, PS dhe LSI.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Zoti Abazi, në lidhje me filmimin e QV, në qoftë se e keni parë, a doni që të paraqitet publikisht këtu në mbledhjen në seancën shqyrtimin administrativ në KAS? Në qoftë se e keni parë dhe nuk keni pretendime të metejshme...

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. B. Abazi, Z. B. Abazi Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Po, faleminderit! Materiali që unë kam marrë, para dy ditëve mbasdite, lidhet me 3 KZAZ me pamje 360 gradë, të tre VNV. Ato kanë qenë megjithatë voluminoze si material dhe ne nuk kemi pasur kohë t'i analizojmë. Vetëm në një KZAZ janë 123 orë filmime. Kurse përsa i përket QV, të cilës ju u referuat ato pamje nuk na janë dhënë ne. Mbase sekretariati ka menduar se ato pamje të shkojnë tek KAS-i për shkak të çështjeve që lidhen me privatësinë e kështu me rradhë.

**Z. L. Braho:** Atëherë, ne e kemi parë, dhe nga informacioni që mu dha nga administrata ditën që i pamë ne, ka qenë pikërisht atë ditë që ju i kërkuat. Jemi vënë në dijeni që i keni parë edhe ju, pavarësisht faktit a i keni marrë në dispozicion apo jo? Por që si filmim e keni parë. Këtë dua të konfirmojë e keni parë apo jo?

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Ajo pamje tek QV nga unë, është parë në prani të drejtorit teknik me një shpejtësi të madhe të filmimit, herë 8 apo herë 12. Pra, si të themi si shkarazi, që nuk më ka dhënë tamam mundësi që të kuptojë tamam se çfarë ka ndodhur aty.

**Z. L. Braho:** Pra, ju pretendoni që nga shpejtësia me të cilën, patë videoon nuk keni arritur që ta kqyrni provën ashtu siç ju do donit për qëllime të këtij hetimi administrativ.

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Po, patjetër.

**Z. L. Braho:** Në rregull. Në lidhje me kryqëzimin e pajisjeve PEI, ju i keni parë, keni pasur interes?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Unë do kisha interes, nuk më janë paraqitur ato prova.

**Z. L. Braho:** Në rregull, administrata mund t'iu véri tani në dispozicion dhe të merrni kohën e duhur. Zoti Logu, ju në lidhje me kryqëzimin e pajisjeve PEI?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po ne kemi marrë dijeni dhe i kemi në dispozicion nga dita e djeshme, nga Sekretari i Përgjithshëm. Vetëm një gjë kisha proceduralisht zoti Braho, mendoj që për sa kohë ne jemi palë në proces, domethënë pavarësisht se kush e bën kërkesën për prova. Provat duhet t'i vihen në dispozicion të gjitha palëve, qofshin palë ankuese, qofshin palë të interesuara e kështu më rradhë. Kështu që besoj ....

**Z. L. Braho:** Kujt prove po i referoheni konkretisht?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Edhe provat po themi që ka kërkuar subjekti ankues PD-AN duhet t'i vihen në dispozicion PS, LSI, po edhe subjektit kandidatit të pavarur zotit Abazi.

**Z. L. Braho:** E zgjidhëm atë zoti Logu. I lamë detyrë administratës që t'ia japi zotit Abazi.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Në rregull, edhe pamjet filmike që ka kërkuar zoti Abazi, nuk është se duhet t'i tregohen vetëm zotit Abazi por duhet t'i tregohen edhe ne, edhe përfaqësuesit të LSI, edhe përfaqësuesit të PS, sepse jemi në një proces ku do të na duhet të mbajmë qendrim. Po sigurisht ne nuk mund të mbajmë qendrim mbi diçka që as e kemi parë dhe sdi për çfarë bëhet fjalë.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. L. Braho:** Patjetër zoti Logu, keni të drejtë. Parimi i kontradiktoraritetit. Kështu që në qoftë se nuk ka kundërshtime nga anëtarët e KAS ne mund t'a trasmetojmë videon këtu, besoj administrata e ka gati, mund t'a demostrojmë videon. Tani mund të biem dakord për shpejtësinë e videos. Se ne e kemi parë videon. Besoj se nuk është nevoja që t'a shohim me një shpejtësi normale se mund të na marri kohë. Sa minuta është video?

**Z. N. Mezini:** Videot janë 1 orëshe dhe normalisht do presim një orë që të presim të tënë. Zotëria e ka parë me 2 herë shpejtësinë ose 4 herë, dukshëm.

**Z. L. Braho:** Në rregull ne mund t'a vëmë videon, të luhet në ekranin e që demostrohet këtu në ambjentet e sallës kuzhvillohet shqyrtimi administrati i KAS. Dhe në çdo moment nëse palët bien dakord mund t'a ndërpresin në qoftë se nuk ka asnjë gjë në interes të çështjes. Po zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Unë kam një pyetje për kandidatin e pavarur. Në qoftë se do shohim videon, minimalisht i takon kandidatit të pavarur të na thotë se çfarë duhet të kërkojmë tek video? Ju mund të na orientoni se çfarë duhet të kërkojmë ne, çfarë duhet të na térheqi ne vëmëndjen tek video?

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Indicia që ne kemi dorëzuar si pjesë e provave tona në ankesë, lidhet me një fotografi të një flete votimi që ka dalë nga ajo QV e gjetur ditën e Hënë paradite në korridorin e "Shkollës Arben Broci" këtu në Tiranë. Kjo është e verifikueshme në dy mënyrë. Së pari nga numri në fletën e votimit që duket qartazi në fotografi, së dyti nga pllakat e korridorit të "Shkollës Arben Broci", të cilat janë të njëjtat edhe me ato që duken edhe në fotografi. Pra, qartazi kemi të bëjmë me këtë

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

QV. Kemi dyshimin që kjo fletë votimi e rregullt, ku kishte një X tek numri 13, është nxjerrë nga kjo sallë, ose duke hapur kutinë, ose dikush e ka futur në xhep, për nga mënyra se si është palosur disa herë, siç vërehet edhe tek fotografia e dorëzuar në KAS. Kështu që mbase diçka mundet të përpinqemi të kuptojmë nga video është kur ka dalë kutia, kush e ka shoqëruar, a shihet ndonjë person që fut materialet zgjedhore në xhep. Po mbase edhe gjëra të tjera të cilat ju mund t'i vërehni edhe vetë.

**Z. I. Rusmali:** Pamjet filmike nga qendra e jatin momentin kur ka dalë kutia?

**Z. N. Mezini:** Nga filmimi duket që organizimi i mbylljes së votimit në atë qendër dhe dalja nga ajo QV.


**Z. I. Rusmali:** Gjatë, pamjeve filmike, ju që e keni parë, ka ndonjë sekuençë ku veprimet e votueësit në dhomën e fshehtë duken të dyshimta?

**Z. N. Mezini :** Në këndvështrimin tim jo!

**Z. I. Rusmali:** Në këndvështrimin tuaj jo! Në këndvështrimin tuaj?

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Nga çfarë mbaj mend nga ato pamje që pashë bashkë me drejtorin teknik. Me një shpejtësi të lëvizjes së videos, këtu mund të më korrigjoj drejtori teknik nëse i kujtohet, është që në një moment dalin kutitë e votimit nga salla, të shqoqëruara më duket nga vetëm një person, Po këtë mundet t'a shohim edhe bashkë. Pjesa tjetër e aty e stafit, e komisionerëve, vëzhguesve qendrojnë bëjnë një fotografi. Nuk kuptohet çfarë ka ndodhur me kutinë, pasi ka dalë nga salla. Nuk kuptohet nëse në korridor ka ndodhur diçka apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Domethënë kjo është e dyshimtë në vlerësimin tuaj?

**Z. B. Abazi Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Nga ato pamje që pashë me shpejtësi kjo mu duk e çuditshme.

**Z. I. Rusmali:** Domethënë a do t'a ndihmonte procesin në qoftë se ne këtë sekuencë t'a shohim me shpejtësi normale. Pra, të mos shohim një orë që nuk janë të dyshimta, por të shikojmë pjesën e fundit të videos ku referohet ajo që thoni juve? Le t'a shikojmë me shpejtësi normale.

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Unë ua lë juve t'a vlerësoni këtë gjë. Domethënë, është e vështirë të them që nga to pamje që unë pashë para dy ditëve me drejtorin teknik, që jam 100% i sigurtë që nuk pati aty, asnjë shkelje. Është e vështirë t'a them këtë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Se u tha domethënë që nga vëzhgimi që i kemi bërë ne, nuk shohim veprime të dyshimta tek dhoma e fshehtë. Me sa shoh unë nga video, ku i bie të jetë dhoma e fshehtë në video, se unë nuk arrij t'a dalloj dot? Mos nuk e kap kamera?

**Z. L. Braho:** Dhoma e fshehtë, se ka qenë një nga kriteret mesa di unë, që të mos kapej dhoma e fshehtë. Madje po të vihet re, edhe kutia e votimit dukej në pjesën majtas lart, pra është kutia e votimit.

**Z. I. Rusmali:** Se ka një gjë, të sqaroj unë pyetjen, dyshimi nga kandidati ishte që fleta e votimit mund të jetë futur në xhep nga zgjedhësi, mbase është gabimi imi. Unë u nisa nga premisa që zgjedhësi që e bën këtë punë e bën fshehurazi. Nuk e bën në faqe të të gjithëve, nuk e bën në shesh, e bën kur është atje ku

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

nuk e sheh njeri.. Dhe mendova, pamjet filmike ndoshta, mund të hedhin dritë në një farë mënyrë tek kjo gjë. Në qoftë se pamjet filmike nuk shohin nga dhoma e fshehtë, ky opson bie. Nuk ka vlerë më video, për këtë hipotezë. Kërkuesi i videos tha që atij i intereson sekuenca e fundit, sekuenca e mbylljes së kutisë dhe e shoqërimit të kutisë jashtë QV. Për hipotezën tjetër që ka ngritur ai. Kështu që hipoteza e parë bie sepse nuk ka mundësi që të verifikohet ajo, ndjekim hipotezën e dytë. Që është ajo e shoqërimit të kutisë, që të mund të ndihmojë këtë hetim që të jemi edhe pak racional tek kërkimet.

**Z. L. Braho:** Atëherë, unë jam i idesë së pjesën fillestare t'a luajmë me një shpejtësi herë dy ose herë tre dhe në momentin që secila nga palët, ka ndonjë pretendim që vë re se po ndodh diçka. Tani meqë po e shohim videon me shpejtësi jo normale t'a luajmë atë dhe në momentin që nga palët ka ndonjë interes atë fragment mund t'a ndalojmë. Tani unë e kam parë videon, gjë, përveçse asaj fotografisë që bënин anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit bashkë me kutinë. Janë edhe palët e tjera. Palët e tjera janë dakord që të luajmë vetëm pjesën e fundit të videos apo duan të shohin gjithë videon qoftë edhe me një shpejtësi më të lartë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Qëndrimi jonë është, domethënë ajo që bëra edhe pyetje ishte për të sqaruar deri në fund, pyetjen e zotit Rusmali sepse ishte një pikë që binim dakord. Pra në qoftë se ne nuk arrijmë t'a shohim po themi dhomën e fshehtë nuk ka se si t'a dimë ne po themi a ka veprime të dyshimta tek dhoma e fshehtë. Kështu që po themi ka një pikë që ramë dakord në këtë pjesë. Për pjesën tjetër zoti Braho mendoj që duke qenë se kandidati i pavarur është subjekti i drejtëpërdrejtë i interesuar dhe ai është duke provuar po themi të provë dyshimet që ka, t'i referohemi kërkesës që ai bën. Në qoftë se ai

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

dëshiron që të shoh vetëm pjesën e fundit, le të shohim vetëm pjesën e fundit dhe t'a verifikojmë çdo gjë që mund të jetë e dyshimtë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu! Pas kësaj dakordësie, po luajmë vetëm pjesën e fundit. Nga momenti i fotografis e në vijim.

**Z. N. Mezini:** Në qoftë se më lejoni edhe me një shpejtësi 2x ose 3 dallohet lehtësisht domethënë. Nuk është se ka humbje të imazhit të figurës. Kështu që të shpejtojmë kohën dhe vemi drejt fundit atje ku është dhe i interesuar edhe subjekti.

**Z. L. Braho:** Atëherë, do i kërkoja kamerave që mos t'a filmojn, meqensëe një nga arsyet që kjo video nuk i jepet palëve është pikërisht për të ruajtur privatësinë e atyre që janë në atë video, përveçse në rastet kur jemi në kushtet e një vepre penale. Kështu që do iu kërkoja që mos t'a filmoni ose kush e ka filmuar mos t'a transmetojë në publik. Kamera e KQZ besoj se nuk po rregjistron videon. Sekretari i Përgjithshëm ka edhe qasje shumë konservatore ndaj të dhënave personale. Atëherë, palët nga filmimet, zoti Abazi nga sa kuptova unë nuk kishte një njeri që të dilte me kutinë. Ishin disa, ishte punonjësi i policisë. Kutia dukej të paktën nga filmimi që u bë kutisë, dukej që ishte kutie e rregullt në kuptim të Kodit Zgjedhor. Pra, nuk kishte dëmtime, ishte e myllur. Nuk e di nëse keni ndonjë koment tjetër në lidhje me videon. Kjo ishte ajo çka ne mund të bënim për transparencë më tepër mundësi nuk kemi për hetimin e asaj çka ju pretendoni. Nëse keni ndonjë koment ju dhe palët e tjera në lidhje me videon.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. B. Abazi, Kandidat i Propozuar nga Zgjedhësit:** Ju falenderoi që e shfaqët këtë filmim, është vështirë të themi si ka ndodhur ky rast, pse është gjendur ajo fletë e votimit në korridorin e “Shkollës Arben Broci” të nesërmen. Nga video është qartazi e pa mundur të kuptohet çfarë ka ndodhur me kutinë përpara që shfaqet në kamera tek ai momenti kur janë të dyja në tokë. Kështu që për momentin mbetet mister.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Logu ju keni ndonjë koment?

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Braho! Ne kemi qenë qëfillim dhe jemi plotësisht dakord me çdo kërkesë që bëjnë subjektet e tjera zgjedhore për transparencë. Zoti Abazi duke qenë kandidat i pavarur nuk ka pasur mundësi që të ketë komisioner në QV apo në raste të caktuara ai pretendon se edhe vëzhguesit janë ndaluar, kështu që çdo pengesë që do vinte për të marrë prova që do zbardhnin do themi, ose do bënин transparencë mbi ditët e numërimit mbi ditën e votimit apo aspekte të tjera të procesit zgjedhor ne do i mbështesnim plotësisht. Nga ana tjetër ne si subjekt zgjedhor PD- AN nuk kemi asnje lloj dyshimi që komisionerët, vëzhguesit dhe numëruesh e Partisë Demokratike kanë bërë një punë të shkëlqyer për të cilin unë gjej rastin edhe t'i falenderoj edhe këtu publikisht. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu! Thjesht për korrigjim zoti Abazi nuk pretendoi që të ketë dërguar vëzhgues dhe mos jenë pranuar në KQV, këtë pretendim e ngriti për KZAZ-në. Gjithësesi për shkak të reformës zgjedhore kësaj here kishte transparencë edhe në KQV edhe për ata që nuk kishin mundësi për vëzhgues, kështu që besoj se rasti i videos është rast suksesi.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

Pavërësish se pretendimi i zotit Abazi mbetet ende mister. Zonja Caka ju keni ndonjë koment në lidhje me këtë provë.

**Znj. S. Caka përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit zoti Braho! Në fakt po diskutonim me kolegun Abazi dhe është e çuditshme vendimmarrja e KAS për të mos marrë të paktën si një lloj prove, pamjet filmike nga drejtoria e shkollës, ku janë zhvilluar votimet, sepse kjo do të na sqaronte se edhe pse kjo fletë votimi gjendet jashtë kutisë së votimit dhe aq më tepër në korridoret e shkollës ku është zhvilluar edhe procesi i votimit. Shumë interesante si vendimmarrje ama deri diku është e kuptueshme.

**Z. L. Braho:** Zonja Caka është e vërtet që kemi marrë një vendim, ka qenë një vendim me shumicë thjeshtë për t'a sqaruar. Pavarësish faktit që unë dhe një nga anëtarët e tjerë kemi votuar pro marrjes së asaj prove e bëm për hirë të transparencës. Por kam përshtypjen se në qoftë se do të vazhdonim me kërkesa të kësaj natyre nuk do t'i vinte asnjë herë fundi sepse do të merrnim filmimet e shkollës, supozohej që nuk do dilte gjë nga shkolla. Më tej do kërkoheshin filmimet e gjithë rrugës që ka ndjekur kutia që nga shkolla deri në KZAZ. Kështu që nuk besoj se ishte kjo mundësia për t'a zgjidhur këtë pretendim. Aq më tepër që nuk është garancia 100% që ka qenë një fletë votimi ajo që është fotografuar. Në qoftë se do te ishte një fletë votimi, pra të na ishte sjellë edhe në cilësinë e provës dhe do kishte dalë që ishte një fletë votimi. Patjetër do kishte interes për ti ndjekur të gjithë këto procedura. Por në kushtet që kemi thjesht një hipotezë besoj se kaq sa bëmë është e mjaftueshme për të treguar gadishmërinë e KAS e KQZ për të bërë transparencë në lidhje me rastin. Gjithsesi faleminderit për sugjerimin! Po zoti Lako.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. L. Braho:** Në qoftë se, do ishte një fltë votimi pra të na ishte sjellë në cilësinë e provës dhe të kishte dalë që ishte fletë votimi, patjetër që do kishte interes për ti ndjekur të gjithë këto procedura por në kushtet që kemi thjesht një hipotezë besoj se kaq sa bëmë është e mjaftueshme për të treguar gadishmërinë e KAS e KQZ-së, për të bërë transparencë në lidhje me rastin. Gjithësesi faleminderit për sygjerimin! Po, zoti Lako.

**Z. E. Lako:** Dua të bëj një sqarim këtu, që përpara se të shkojmë te kërkimi i marrjes së provave për të zbuluar që mungon një fletë votimi së pari vetë ju si palë të interesuar mundet që të kishit bërë një kërkesë ose një kërkim të provave të administruara të materialeve zgjedhore për të parë që nga proces-verbali i mbylljes 08 apo të gjithë materialeve të tjera zgjedhor a është konstatuar nga ky komision mungesa e një flete votimi? Kjo është hapi i parë që do pasonte pastaj që nqs do ishte konstatuar mungesa e kësaj flete votimi, ne do kalonim për të gjetur se si ka dalë kjo fletë votimi dhe kush është shkaku që kjo nuk gjendet në kutinë apo në matrialat zgjedhore! Nëse nuk ka konstatim nga komisioni që mungon kjo fletë votimi, atëherë neve jemi duke kërkuar në ajër një gjë që nuk ekziston. Kaq koment kisha!

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Lako, atëherë debati në lidhje me këtë provë të administruar e konsiderojmë të mbyllur, vijojmë me provën tjetër. U njohët të gjithë palët edhe ju zoti Salianji që u paraqitët tanë në lidhje me kryqëzimin e të dhënavë të pajisjeve PEI për Qarkun e Tiranës? Zoti Abazi!

**Z. B. Abazi, kandidat i pavaruar:** Po sapo i morëm, skam patur mundësi ti shikoj.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. L. Braho:** Dakord, vazhdojmë atëhere me pretendimet, zoti Logu atëherë, në zbatim të nenit 141, të Kodit Zgjedhor e konsiderojmë të mbyllur hetimin administrativ duke qënë se nuk ka kërkesa të tjera për prova apo për të depozituar prova kështu që vijojmë me pretendimet përfundimtare. Për ti dhënë kohën e mjaftueshme dhe zotit Abazi që të njihet me këtë provë të fundit. Vijojmë me zotin Logu për pretendimet përfundimtare të subjektit zgjedhor koalicioni PD-AN.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti drejtore i seancës. Parashtimet ose konkluzionet tona përfundimtare i kemi me shkrim, i kemi në tre kopje nga 9 faqe, në qoftë se mund të afrohem për t'jua dhënë në dispozicion.

**Z. L. Braho:** Po, patjetër mund t'ja jepni administratës ose sillini.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Me lejen tuaj! Faleminderit zoti Braho, Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim ka paraqitur në datën 09 Maj 2021, një kërkesë ankimore pranë Komisionit të Ankimevë dhe Sanksioneve. Në të cilin ka kërkuar ose ka kundërshtuar vendimin e vendimit nr.343, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore, Qarku Tiranë. Duke kërkuar njëkohësisht pavlefshmërinë në zgjedhjet e zhvilluara në datën 25 Prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Nga ana e Partisë Demokratike në emër të Aleancës për Ndryshim ju është vënë në dispozicion dhe është paraqitur përpara jush një material ankues prej 89 faqesh të mbështetura në 88 prova duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet që kanë ndodhur në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Në periudhën para gjatë dhe pas zgjedhore, të cilat në vlerësimin tonë përbushnin kriteret e nenit 160 për konkluduar mbi



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

pavlefshmérinë dhe kriteret e nenit 161 për të konkluduar mbi përsëritjen e zgjedhjeve në gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Ne kemi parashtuar përpara këtij komisioni se si drejtues të lartë të Partisë Socilaste, funksionarë publik në bashkëpunim me elementë të krimit të organizuar u përfshinë në një sërë veprimtarish të paligjshme të cilat sigurisht do të duhet ti përmendim edhe sot për të legjitimuar kërkesën që ne kemi bërë. Ne kemi parashtuar përpara këtij komisioni se shtetasit Erjon Veliaj Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe drejtues i Partisë Socialiste për Tiranën. Belinda Balluku, Ministre për Infrastrukturën dhe Energjinë, kandidate për deputete për Partinë Socialiste në zonën e Kombinatit. Arben Ahmetaj, Ministër Shteti për rindërtimin dhe kandidat për deputet. Tom Doshi, deputet dhe Kryetar i Partise Socialdemokrate. Ervin Bushati, Deputet dhe Kryetar i Partisë Socialiste në Tiranë. Sadri Abazi, Deputet i Partisë Socialiste, kandidat për deputet. Rakip Suli, Kryetar i Bashkisë Kamëz. Redjan Krali, Kryetar i Bashkisë Kavajë, si dhe shtetas të tjerë janë përfshirë me drejtues lokal të institucioneve qëndrore apo vendore. Përfaqësues të Partisë Socialiste, individ të skeduar për rekorde të rënda kriminale, duke ngritur një strukturë kriminale të blerjes së votave qoftë kjo nëpërmjet parave, ndihma ushqimore, kuponave të kartave të identitetit, dhënes së përfitimeve të tjera por edhe nëpërmjet kërcënimeve presioneve ndaj votuesve. Ndaj këtyre shtetasve Partia Demokratike, në përputhje me nenin 283, të Kodit të Procedurës Penale ka depozituar në Prokurorinë e Posacme kundër Korruptionit dhe Krimtit të Organizuar, 7 kallëzime penale, përkatësisht në datat 04 Prill, 06 Prill, 07 Prill, 12 Prill, 15 Prill dhe 18 Prill, për veprat penale të korruptionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, përdorimin e funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, shpërdorimin e detyrës, marrjen ose përdorimin e paligjshëm të dokumentit të identifikimit si dhe kanosjen apo kërcënimin e zgjedhësve. Krahas blerjes së votave për kundrejt të hollave nga 100 deri në 300 euro ne ju parashtuam se me qëllim manipulin e vullnetit të

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së*

*Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve*

*Dt.27.05.2021*

zgjedhësve janë shpërndarë 125 milion euro nga fondi rindërtimit nga bashkitë socialiste ndër të cilat sigurisht janë edhe bashkitë e Qarkut Tiranë, Bashkia Tiranë, Kamëz, Kavajë dhe Rrogozhinë. Po ashtu, Partia Demokratike ka vendosur në dispozicion të këtij komisioni pamje filmike foto dhe video të 42 rasteve ku shfaqen ministra, deputet, kandidatë dhe drejtues të Partisë Socialiste, duke shpërndarë ndihma ushqimore për familjet në nevojë ose dhurata për kategori të caktuara shoqërore. Shembull flagrant është Kombinati ku ishte ngritur një skemë e strukturuar nga vetë Ministria Belinda Balluku për shpërndarje ndihmash ushqimore, familjeve të varfëra të komunitetit Rom në zonën e Kombinatit. Ndërsa qeveria dhe Bashkia Tiranë nxorrën një serë vendimesh të cilat sillnin përfitime për kategori të caktuar në shkelje dhe kundërshtim të hapur me parshikimet e nenit 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor, që ndalon nxjerrjen e akteve ligjore apo nën ligjore që sjellin përfitime për kategoritë e caktuar shoqërore në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Sigurisht që krahas të gjitha provave që ne kishim në dispozicion, 88 në numër. Ne treguam provat e tjera që ky komision duhet të merrtë për të vërtetuar pikërisht këto pretendime. Pra, faktin se çfarë kishte ndodhur me hetimet që janë kryer nga Prokuroria e Posacme, kundër Korruptionit dhe Krimtit të organizuar lidhur me 7 kallzimet tona penale, se sa kanë qenë rastet kur vetë Drejtoria e Përgjithshme e Drejtoeisë së Shtetit ka arrestuar, ka ndaluar apo ka proçeduar shtetas për krime zgjedhore! Të kërkojë informacion pranë bashkive, Drejtorisë së Rezervave të Shtetit dhe inpsktoriateve qoftë atij qëndror apo të tjera, në mënyrë që të zbardheshin të plota të gjitha pretendimet që kishte ngritur Partia Demokratike që sigurisht nuk ngeli vetëm në stadin e pretendimeve, por faktoheshin dhe vërtetoheshin nga një numër shumë i madh provash që ne ua vuam në dispozicion. Në mënyrë krejtësisht të pa kuptimtë ashtu siç është bërë zakon në fakt dhe siç keni vepruar dhe në raste të tjera, U refuzuan kërkesat tona duke bërë kështu refuzimin e


*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

të drejtës për transparencë që kemi ne si subjekte zgjedhore që kanë qytetarët e Tiranës por dhe qytetarët e të gjithë Shqipërisë, për të bërë transparencë të plotë mbi të drejltën, mbi blerjen e votës dhe tjetërsimin e vullnetit të zonës në Qarkun e Tiranës, qoftë nëpërmjet parave me burim krimin e organizuar apo buxhetin e shtetit. Ne parashtruam përpara këtij komisioni se shteti vendosi në dispozicion të Partisë Socialiste tendera Konçsione Pipipive dhe të gjitha investimet e tjera publike. Kjo në vlerësimin tonë pëben një shkelje flagrante të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit nr.3 të vendimit nr.9 2020 të Komisionit Rregulator. Shkelje të tilla u përsëritën masivisht në të gjithë vendin, ne kemi pasur mundësinë të identifikojmë 781 raste. Ne ju parashtruam se në të paktën 22 raste gjatë fushtës zgjedhore filloj shtrimi i rrugëve në njesi të ndryshme të Bashkisë Tiranë të cilat ishin kryesish punime që kryheshin natën, pa asnjë njoftim pa asnjë procedurë prokurimi publik, pa asnjë informacion mbi projektin pa informacion mbi fondin limit, autoritetin kontaktorë, operatorin ekonomik, fillimin dhe përfundimin e punimeve. Pra të gjitha këto punë publike kryheshin pa pasur asnjë lloji transparence, thjeshtë dhe vetëm me qëllim manipulimin apo tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve të Qarkut të Tiranës. Fondet e rindërtimit, po ashtu përdoren për qëllime të pastra elektorale duke përfshirë në skemën e dëmshpërbimeve drejtues, përfaqësues, zyrtarë lokal të Partisë Socialiste apo familjar të tyre siç kanë qenë raste të shumta që ne i kemi denoncuar në Bashkinë Kavajë apo në Bashkinë Rrogozhinë, të cilët në fakt nuk ishin aspak të dëmtuar nga tërmeti. Në materialet që ne kemi depozituar në dosjen tonë ka foto të banesave të këtyre shtetasve që kanë përfituar fonde nga rindërtimi, që dukshëm duken edhe me pamje të lirë që nuk janë prekur ose dëmtuar nga tërmeti i Nëntorit 2019. Në parashtruam përpara këtij komisoni së në vitin para zgjedhor 2020, u prokuruan 878 kontrata publike me vlerë 505 milion euro, ose 500% më shumë sesa mesatarja e 5 viteve të fundit. Ne treguam raste se si shtetas me rekorde të tmerdhme kriminale si

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

rasti i Aleksandër Lipivjanit, Emiljano Dushës, Ardian Davidhit, Rexhep Spahiut, Marlin Shkrelit dhe tjerë e tjërë. Përfituan nëpërmjet kompanive të tyre tendera dhe kontrata publike, nga institucionet e administratës me vlerë 17 milion euro. Ndërkohë se nëse do të verifikohej dokumentacioni i realizimit të këtyre procedurave të prokurimit publik do të vëreheshin shkelje të renda të ligjit për prokurimet publike. Qëllimi është i qartë, paratë që ju transferuan këtyre shtetasve nga buxheti i shtetit u përdorën më pas masivisht për blerjen e votave apo manipulimin e vullnetit të zgjedhësve. Për të vërtetuar pikërisht këto pretendime më shumë se sa kishin bërë me 88 prova që ne ju vumë në dispozicion. Ne kérkuam nga ana e këtij komisionit në mënyrë të përsëritir së paku në 6 kërkesa të ndryshme, të merrtë prova pranë Agjensisë së Prokurimeve Publike për numërin e Tenderave, Koncesioneve, Pipipive të shpallur rishtazi apo për të cilët janë shpallur fituesit në perjudhën Dhjetor 2020-Maj 2021. Por, sigurisht dhe pa asnjë habi edhe kjo provë u refuzua nga ana juaj. Duke berë kështu, ju keni refuzuar të drejtën për transparencë se si partë e taksa paguesve shqipëtar u vendosën në fakt në funksion të Partisë Socialiste, në Qarkun e Tiranës. Ne parashtruam se punonjësit e Administratës Shtetërore në Tiranë, Kamëz, Vorë, Rrogozhinë, Kavajë u kërcënuan, u intimiduan dhe u vendosën në presion të vazhdueshë nga eprorë e tyre për të sjellë vota në favor të Partisë Socialiste. Ne sollëm fakte dhe prova të shumta se si administrata e Bashkive Tiranë, Kamëz, Rrogozhinë dhe Kavajë. Administrata e Ministrisë së Shëndetsisë, Administrata e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, u vendosën tërësisht në dispozicion të shefave të tyre politik, për maksimizimin e votave për Partinë Socialiste. Shembujt flagrant janë faktet se si në zonën e Kombinatit, administrata e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ishte tërësisht e përfshirë në fushtën e politike të shefes së tyre zonjës Belinda Balluku. Ne parashtruam faktin se administrata shtetërore u rrit me 13 mijë punonjës në rreth 4 muaj dhe faktin se


*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

pagat u rritën me 63 milion euro, nuk u rritën pagat po u rritën pagesat për këta punonjës të rinjë dhe vetëm në Bashknë Kamëz, numëri i punonjësve të rinj shkoj në 1003 punonjës në kundërshtim të hapur me nenin 91 pika 3 të Kodit Zgjedhor, i cili ndalon qartazi se në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve të punësohen njërez të rinjë qofshin me kontrata të përkohshme, qofshin me kontrata të përhershshmë përveçëse kur e diktojnë nevojat e ngutëshme. Cilat kanë qenë nevojat e ngutëshme që kanë diktuar punësimin e 1003 punonjësve në Bashkinë Kamëz? Këtë nuk di askush ta thotë! Përveqëse detyra që i kishin vënë drejtuesit politik, kryetarit të kësaj bashkie për të maksimizuar votat për Partisë Socialiste. Ne parashtruam faktin se në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave u punësuant rrith 150 punonjës të rinjë dhe sigurisht arsyaja po themi gjithmonë e njohur se herë që ka zgjedhje, Drejtoria e Arkivave kërkon të bëjë dixhitalizimin e dokumentave të arkivës. Ndërkohë që në Bashkinë Rrogozhinë u shtuan 227 punonjës të rinjë. Do të kërkoja pak qetësi zoti kryesues i seancës! Po ashtu një rast flagrant i paligjshërisë së ngritur në sistem, janë email të Oligerta Manastirliut, Ministre e Shëndetësisë dhe kandidate për deputet të Partisë Socialiste që ju kërkon strukturave të PS ti sjellin propozimet e tyre përvende të hapura rishtarzi në administratë. Ne i kemi parashtruar këtu se ju paguhen 2.6 milion euro më shumë ndihma ekonomike apo 1.9 milion euro më shumë paga lufte se në të njejtën periudhë krahasur me vitin e mëparshëm. Sigurisht, që të gjitha provat që ju kemi vënë në dispizicion, këto 88 prova kishin nevojë që të faktoheshin e të vërtetoheshin më tej edhe me prova të tjera të cilat ne i kemi renditur në mënyrë të përsëritur plot 114 herë përpara këtij komisioni, që kishin të bënin me marrje provash pranë departamentit të administratës publike, bashkive të vendit, shoqërive aksionare, agjensitë e varësisë të ministrite të bashkive, për numërin e të punuarve qofshin këta me kontratë të përhershme apo të përkohëshme. Kërkua që të merrët informacion në cilësinë e provës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

Sociale si dhe 61 bashkive. Lidhur me numërin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe ndryshimin e masës gjatë peridhës Janar-Prill 2021. A e ezauruam ne marrjen e këtyre provave vetë nga ana jonë? Ne ju vumë në dispozicion 100 kërksa për informacion, të cilat i janë drejtuar Organeve të Administratës Publike dhe deri më sot kemi 0 përgjigje. Asnjë përgjigje, asnjë lloj transparence nga ana e këtyre organeve publike, se si u përdorën paratë e taksa paguesve shqipëtar për të ndikuar vullnetin e tyre në zgjedhjet e 25 Prillit. Ne prisnim në fakt që transparencën që refuzojnë institucionet me drejtues politik, ta bëntë Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve! Por, fatkeqësusht Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve u soll si drejtuesit politik të Partisë Socialiste në krye të institucioneve. Ne parashtruam se lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdorën masivisht nga Partia Socialiste për tu përkthyer në vota në mbështetje për të dhe kandidatët e saj. Rast flagrant është fakti se si Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës Belinda Balluku, premtonte dhe shpërndante leje legalizmi dhe leje ndërtimi për qytetarët e saj në zonën e Kombinatit. Rast flagrant është fakti se si ish Ministri i Brendshëm dhe kandidati për deputet i Partisë Socialiste Fatmir Xhafaj premtonte dhe shpërndante leje legalizimi është rast flagrant i denonuar me foto e video me pamje filmike fakti se stafi i ngushtë i Ministres Etilda Gjonaj ishte përfshirë në shpëndarjen e lejeve të legalzimit, është fakt i denonuar publikisht dhe i provuar nëpërmjet provave që ju kemi vënë në dispozician se këtë gje e bëntë edhe Kryetari i Bashkisë Tiranë Erjon Veliaj. është fakt publik dhe i denonuar se Krykomisioneri i paligjshmërisë në Kuvendin e Shqipërisë Ulsi Manja premtonte dhe shpërndante masivisht leje legalzimi në këmbim të votave. Kemi patur mundësinë ta parashtrojmë përpara jush se në fakt një model të ngjashëm me atë që kishte ngritur Ministria Balluku, në zonën e Kombinatit kishte në të gjithë Qarkun e Tiranës, një skemë në fakt e shpëndarë në të gjithë Shqipërinë, siç është faktuar nga bisedat fatmirsisht ne patëm mundësinë të


*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

disponojmë edhe një telefon të njërit nga personat që ishte pjesë e ketyre grupeve, se drejtues të Shtabit Elektoral të Ministres Belinda Balluku, komunikon me strukturat lokale të Partisë Socialiste dhe më pas ato dakortësoheshin për të shpërndarë leje legalzimi qytetarëve të ndryshëm në këmbim të votave. Kemi denoncuar rastin publikisht se si në zonën e Vaqarrit, strukturat e Partisë Demokratike së bashku me kandidatin tonë për deputet atje zotin Belind Këlliqi, denoncuam një makinë e cila në mes të ditës shpërndante para, ndihma ushqimore dhe leje legalizimi në këmbim të votave. Ne kemi parashtruar faktin publik pë sa i përket audio dëgjimit të drejtorit Publik të Kadastrës tek i cili nuk dëshiroj të ndalem më shumë por është po ashtu fakt që ai fliste për 160 mijë kërkesa, për leje legalizimi që do trajoheshin varësisht nga nevoja që do të kishte Partia Socialiste. Ndërkohë që pas zgjedhjeve për ironi të fatit shfaqet Ministri i Punëve të Brendshme Bledar Çuçi duke përbetuar se ato që ndërtojnë pa leje do të ndëshkohen me 10 vite burg, të paktën deri në fushtën e ardhëshme elektorale. Krahas 88 provave tona ne ju treguam provat e tjera që ky komision duhet të merrte, për të vërtetuar pikërisht këto fakte të denoncuara publikisht, e konkretisht provat pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, 61 bashkive të vendit për sa i përket lejeve të ndërtimit, apo Agjensisë Shtetërore të Kadastrës për sa i përket lejeve të legalizimit. Është fakt po ashtu i bërrë publik nga media, se në periudhën Janar-Mars 2021, janë shpërndarë 10 mijë e 3 leje legalizimi që nënkuqtojnë leje për 10 mijë e 3 familje. Jemi të bindur që në qoftë se ky komision do të pranonte këkesën e drejtë dhe të ligjshme të Partisë Demokratike dhe Aleancës për Ndryshim për të bërrë transparencë të plotë, numëri i lejeve të legalizimit të shpërndara pë gjatë peridhë Janar-Prill 2021, do të ishte disa herë me shumë. Çka tregon për një shkelje të pastër të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe po ashtu edhe të vendimit nr. 9/2020.

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:**... tërësisht synonte, që vetëm e vetëm, të mos lejonte asnjë parti politike, e veçanërisht në pushtet, të pengonte të vinte në funksion të saj të gjitha asjetet, të gjitha burimet, lejet, licencat, prokurimet, vetëm e vetëm për ti përkthyer në vota për PS-në dhe kandidatët e saj. Edhe kjo kërkesë, në vlerësimin tonë, krejtësisht në kundërshtim me nenin 137 të kodit zgjedhor, u refuzua nga shumica e anëtarëve të këtij komisioni. Ne parashtruam përpara këtij komisioni, së si në fakt, mbështetësit e PD-së u kërcënuan e u dhunuan. Ne kemi denoncuar përpara këtij komisioni, faktin së si Fatmir Basha, vëllai i bashkëshortes së kryeministrit Edi Rama, kërcënoi drejtpërdrejt një drejtor shkolle private, në Tiranë, se nëse përfshihej në mbështetje të PD-së, shkolla e tij do të mbyllej. Njerëz të afërt të Arben Ahmetajt dhunuan aktivistin e PD-së, Dorian Protoduari, në zonën e unazës së re. Zyrat elektorale të PD-së në njësinë nr. 7 u dëmtuan nga persona të paidentifikuar, por që qartësisht ishin mbështetës të PS-së, rast për të cilin, policia e shtetit as gishtin nuk lëvizi për të zbuluar se çfarë kishte ndodhur. Ne e denoncuam publikisht faktin së punonjësit e policisë, përkatësisht Agim Hoxha, shef komisariati tek komisariati nr. 4 në Tiranë, Nexhip Dedaj, Florenc Karaj dhe Shpëtim Gjonaj përdornin pushtetin e tyre si drejtues policie për të kërcënuar arrestuar e dhunuar shtetas në zonën e freskut, me qëllim detyrimin e tyre për të mbështetur PS-në. Rast flagrant i kësaj paligjshmërie të ngritur në sistem është fakti së sekretari i degës së PD-së në Kavajë, u plagos me armë zjarri në zyrën e PD-së, nga Ndriçim Jonuzi, i shoqëruar nga Markel Shtylla, drejtor i policisë bashkiake Kavajë dhe Dorian Troplini, polic bashkiak. Më herët këta shtetas ishin parë dhe filmuar në një drekë me kryetarin e bashkisë Kavajë, Redian Krali. Mbase mund të duken zgjedhje të ligjshme për ju, për tre anëtarë të këtij komisioni, por për në nuk mund të jenë kurrsesi të lira.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Logu! Tani më duhet t'ju tërheq vëmendjen! Ne nuk jemi shprehur, as tre, as katër, as pesë, lidhur me këtë vendimmarrje, kështu që mos paragjykoni vendimmarrjen; apo ndonjë anëtar të KAS-it. Ju keni të gjithë të drejtën tuaj të vijoni me ato kërkesa që janë refuzuar për këtë qark, deri më tani, që kanë të bëjnë edhe me provat, jam shumë dakord që ju të shpreheni se janë rreziuar në kundërshtim me ligjin, por mos paragjykoni vendimmarrjen pavarësisht idesë që mund të jetë krijuar tek ju apo tek ndonjë tjetër.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** zoti Braho, paragjykimi si koncept ka vlerë për sa kohë nuk ke fakte për të kundërtën; për sa kohë që ne kemi 5 kërkesa të rreziuara nga ana e këtij komisioni, kemi 114 herë të rreziuara kërkesat tonë për transparencë, kjo nuk është më paragjykim ky është një gjykim mbi sa e sa fakte, që janë të shprehura publikisht.

**Z. L. Braho:** Zoti Logu! Nuk është radha për debat!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne nuk po ju paragjykojmë! në po ju gjykojmë mbi këtë vendimmarrje që është bërë.

**Z. L. Braho:** Zoti Logu! Nuk e shtrova për debat atë që të thashë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord! Dakord! Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Thjesht vijoni pa etiketime për ndonjë nga anëtarët e KAS-it.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio*

*Aleksandër PRENGA*

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.05.2021*

**Z. L. Braho:** Dhe kjo e thënë nga unë, që nuk prekem nga deklaratat tuaja, se kam qenë pro kërkesave tuaja, besoj që duhet t'ju bëjë që të reflektoni pak më shumë. Faleminderit!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Braho! E thashë edhe një herë që ky nuk është paragjykim por është gjykim! Gjithsesi, nëse qytetarët kërcënohen, frikësohen dhe plagosin, atëherë nuk e kuptoj për çfarë standardi zgjedhjesh po flasim?! Çfarë parimesh mbrojmë ne këtu?! Cilat janë standardet që duhet të vendosen në proceset zgjedhore?! Apo standardet dhe parimet ua kanë lënë vandin urdhërave politikë, të Edi Rames, Taulant Balles, Damian Gjiknurit dhe Engjell Agaçit! Ne parashtruam së zyrat elektorale të PS-së u shndërruan në zyra të gjendjes civile, ku qytetarët duhej të paraqiteshin për të transferuar gjendjen civile. Kemi sjellë fakte dhe prova për situatën shumë të rëndë, së si vetëm në zonën e Yzberishit, popullsia u rrit nga 8000 në 22000 banorë në vetëm 4 muaj. Ose 63% me shumë! në qoftë se Republika e Shqipërisë do të kishte këtë rritje popullsie siç ka ndodhur në zonën e Yzberishit, me siguri popullsia sot do të ishte rrëth 6-7 milion banorë. Por është fakt i denoncuar publikisht edhe në media, së kishte me qindra familje që ishin vendosur në mënyrë fiktive, në të njëjtën adresë, me kontrata fiktive qiraje. Nuk e di së si mund të jetojnë 200 apo 300 familje në një garazh atje diku në zonën e Yzberishit. Ne parashtruam përpara këtij komisioni, në fakt, një fakt shumë të rëndë sidomos për qarkun e Tiranës. Si u vodhën në mënyrë të paligjshme të dhënat e 910 mijë qytetarëve, nga patronazhistët e PS-së, për të cilët kryeministri dhe kryetari i PS-së, Edi Rama, apo sekretari i përgjithshëm, apo drejtuesi politik i Tiranës, nuk kursejnë asnjë rast për ti falënderuar, për fitoren, sipas tyre, historike, të 25 prillit. Krahas provave që ne në fakt ju kemi vënë në dispozicion, të cilat do të kishim dashur shumë që të vlerësoheshin me objektivitetin e nevojshëm. Ne iu kërkua


*Zbardhi materialin audio*

*Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.05.2021*

edhe për prova të tjera që do të duhej të merreshin pranë prokurorisë së posaçme kundër korruptionit dhe krimit të organizuar, lidhur me skandalin e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave personale. E kaluat këtë moment pa u ndalur për asnje sekondë në shqyrtimin e kësaj prove, kur në fakt, thjesht dhe vetëm kjo ngjarje, kjo paligjshmëri që ka ndodhur, duhej të mjaftonte për të shkuar në pavlefshmëri të këtyre zgjedhjeve. Ne parashtruam së vendimi i komitetit teknik të ekspertëve iu hoqi mundësinë dhe të drejtën për të votuar rreth 500 mijë shqiptarëve me të drejtë vote, me banim në Greqi dhe Maqedoninë e veriut, ndërkohë që në qarkun e Gjirokastrës, së paku, në ia arritëm të provojmë që votuesit e partisë socialiste, jo vetëm që kishin hyrë pas vendimit për garantinimin, por edhe shërbyen në administratën zgjedhore si komisionarë apo numëruar të PS-së. Ne, sigurisht që, kërkua për ta provuar deri në fund të vërtetën e kësaj ngjarje, pranë institucioneve, sidomos pranë drejtorisë së policisë së shtetit, se sa ka qenë numri i qytetarëve që kanë hyrë në Shqipëri nga Greqia apo nga Maqedonia e veriut, pas datës 19 prill deri në 25 prill, dhe sigurisht një kryqëzim i të dhënave që do të vinin nga policia e shtetit, me ata qytetarë që kanë marrë pjesë do të provonte faktin dhe paligjshmërinë se vendimi politik i komitetit të ekspertëve u mor për të ndaluar mbështetësit e opozitës të vinin për të votuar për ndryshimin në 25 prill. Ne parashtruam përpara këtij komisioni së një vendim tërësisht i paligjshëm, për mendimin tonë, dhe do të vazhdojmë ta përsërisim, solli 18422 fletëvotimi të pavlefshme, në qarkun e Tiranës, të cilat në vlerësimin tonë, ishin të mjaftueshme për një mandat në qarkun e Tiranës dhe sigurisht për të ndryshuar edhe rezultatin. Fatmirësisht, për shkak të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, në arritëm të marrim të dhënat e pajisjeve PEI, falë vendimmarrjes së dy anëtarëve të KAS-it, të cilat na dëshmojnë për dyshime krejtësisht të mbështetura dhe të arsyeshme së potencialisht 51 persona kanë votuar 123 herë në qarkun e Tiranës, kjo nga provat që na janë vënë në dispozicion nga ana

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.05.2021*

e administratës së KQZ-së me anë të shkresës me nr. prot. 5501, datë 26.05.2021. Ne sigurisht kemi për detyrë që ti denoncojmë këto raste të renda, siç janë rastet flagrante të blerjes së votës, nga drejtues të partisë Socialiste me individë me rekorde kriminale; të shkrirjes së shtetit dhe të partisë në një të vetëm; të vjedhjes dhe të përdorimit të paligjshëm të dhënavë personale; mohimi i të drejtës së emigrantëve; të pavlefshmërisë së vullnetit të qytetarëve, apo edhe rastet flagrante të votimit të shumëfishtë. Por sigurisht, prova që ne kemi vënë në dispozicion dhe të gjitha shpjegimet tona, kërkonin që të vërtetonin dhe të faktoheshin më tej edhe nëpërmjet provave të kërkuaara nga ne dhe që duhej të merreshin nga ky komision. U refuzua jo një herë, jo dy herë, po 114 herë janë kërkesat e refuzuara PD-së që kishin për qëllim për të bërë transparencë për 25 prillin. Zakonisht, në këtë proces i nderuar, në përfundim të konkluzioneve tona, në kërkojmë që komisioni të sillet në përputhje me ligjin, të mos sillen si noter të masakrës zgjedhore, por pasi kemi parë 5 vendimmarrje publike të këtij komisioni, kjo kërkesë nuk ka më kuptim, sepse, ...

**Z. L. Braho:** Zoti Logu! Më duhet t'ju ndërpres sërish! Tani ti heqim këto termat! Ne të gjithë jemi kolegë këtu. Kemi qenë të gjithë nëpër seanca gjyqësore, jo nëpër seanca të shqyrtimit administrativ si kjo e sotmja, dhe të paktën në seancë ata që marrin vendime nuk etiketohen! Patjetër që ju e keni të drejtën që të bëni të gjithë etiketimet e mundshme ndaj kujtdo anëtari të këtij komisioni apo edhe të komisionit në tërësi, por jo gjatë zhvillimit të seancës. Kështu që ju lutem, përbledhtazi, çfarë kërkon nga KAS-i me këtë kërkesë ankimore tuajën. Me gjithë paragjykimet që ju keni, dhe pa dyshim që është e drejta juaj që ti keni duke u nisur edhe nga vendimmarrjet e deritanishme, por ju lutem për çështjen që kemi objekt gjykimi administrativ, përfundimet lidhur me kërkesat tuaja. Faleminderit!



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** zoti Braho, mendoj që është fakt publik së 5 kërkesa të subjektit zgjedhor PD & AN, janë refuzuar! 114 kërkesa të tjera për transparencë janë refuzuar; ne nuk presim asgjë nga ana e këtij komisioni,

**Z. L. Braho:** Ky nuk është vetëm fakt publik, është edhe fakt juridik, zoti Logu, jam shumë dakord me ju! ...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Të lutem! Me lini të përfundoj!

**Z. L. Braho:** Por, gjithsesi këtë seancë e kemi për qarkun e Tiranës; ju keni bërë një kërkesë ankimore, ... e ka bërë edhe....,

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Shumë mirë! Unë të kuptoj ...,

**Z. L. Braho:** E ka bërë edhe zoti Abazi, ... kështu që ju lutem!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Braho, me gjithë respektin dhe konsideratën për ju, por do të doja me që jam në konkluzione përfundimtare, do të doja të më lejonit që unë të përfundoj ashtu si ne e mendojmë më mirë, ashtu si ne e mendojmë më saktë dhe pastaj sigurisht që ju do të keni të drejtën të tërhiqeni në dhomë këshillimi dhe të merrni vendimin tuaj, për të cilin ne, sigurisht, mund të kemi pritshmërinë tonë që dhe do ti shprehim publikisht. Kështu që besoj që nuk ka kuptim që të bëjmë debat në konkluzionet përfundimtare të palëve.

**Z. K. Bele:** Zoti Logu duhet të keni respekt, ... në qoftë se e keni të pamundur të keni respekt për këtë trupë, në qoftë se atë nivel edukate keni që manifestoni, duhet të



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.05.2021*

keni respekt për profesionin që keni dhe për subjektin që përfaqësoni. Në mënyrë të përsëritur vazhdoni të etiketoni dhe të flisni në mënyrë jo etike; së paku ruani etikën; fakti që rrezohen kërkesat, kjo ndodh në procese gjyqësore në gjykatë, në procese administrative, etj.; mund të jetë cilësia e kërkesës, mund të mendojë dikush, mbas keni bërë kërkesa të cilat ligjërisht nuk qëndrojnë; mundet që kjo trupë e shikon ligjin në mënyra të ndryshme, por nuk ju takon në mënyrë profesionale; keni një karrierë përpara, respektoni veten dhe n.q.s. nuk respektoni veten, kini respekt për partinë e madhe që përfaqësoni.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ju përsëris edhe një herë zoti Braho që në konkluzione të mos ndërpritem aq më tepër nga persona që shkeljen e ligjit e kanë bërë rutinë në këtë proces; të mos më mbajnë as leksione etike, as ...,

**Z. L. Braho:** Zoti Logu, jua thashë edhe qëparë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Këtu nuk vijmë për të folur për etikën e njërit apo tjetrit ..., këtu kemi ankime, ... duhet ti paraqesim dhe do ti paraqesim ashtu siç ne e mendojmë më mirë!

**Z. L. Braho:** Zoti Logu! Atëherë, kur flas unë

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ju lutem lejomëni të mbaroj konkluzionet ...,

**Z. L. Braho:** ... kur flas unë, heshtni ju dhe kur flisni ju hesht unë! Këto janë parime të këtij shqyrtimi.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord! Për këtë ju kërkoj ndjesë!

**Z. L. Braho:** Dhe një herë! Keni të gjithë të drejtën e mundshme që ju jep ligji, ju jep Kodi zgjedhor, ju jep rregullorja e funksionimit të seancave të KAS-it, por ju lutem pa etiketime! Vijoni me kërkesat tuaja! Mund ta bëjmë edhe kështu. Bëj unë një pyetje dhe më jepni ju përgjigje! Vijoni të keni pretendime dhe të kérkonи pavlefshmérinë e zgjedhjeve në qarkun e Tiranës?! ... dhe përsëritjen në një afat sa më të shkurtër të mundshëm të zgjedhjeve në qarkun Tiranë?!


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Kjo është pyetje retorike! Sigurisht që në i qëndrojmë të gjitha kërkesave që kemi paraqitur përpala këtij komisioni; pavlefshméri të zgjedhjeve; përsëritje të tyre; por për sa kohë urdhrat politikë vijnë në telefonat e anëtarëve të KAS-it nga Edi Rama, Taulant Balla e Damian Gjiknuri!

**Z. L. Braho:** Zoti Lako e relatoj unë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Unë i mbylla konkluzionet e mia! Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Dakord! Faleminderit! Nëse keni ndonjë gjë të re apo ndonjë shqetësim në lidhje me telefonat, të jeni i hapur, telefonin tim mund ta keni që tani; së di për anëtarët e tjerë të KAS-it; po besoj që këto nuk janë mesazhet e duhura që mund të jepen në një seancë shqyrtimi administrativ. Mund të dilni jashtë! Mediat i keni këtu dhe të bëni të gjithë deklaratat e mundshme politike. Faleminderit!

Zoti Abazi jeni i gatshëm që të vijoni me konkluzionet tuaja bazuar edhe në provën e fundit që u vu në dispozicion nga ana e KQZ-së?



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.05.2021*

**Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Faleminderit! Problemi është që jemi pak në një situatë absurde, brenda kësaj salle, sepse ju që ma dhatë fjalën, që jeni aty, palët që po ankohen, sekretariati, publiku, të gjithë presin që ju do e rrezonit ankesën tonë, 3 me 2 siç është vepruar në të gjitha rastet e kaluara! Kështu që meqenëse kjo pritshmëri e publikut, e juaja e jona, e sekretariatit po së po, e vërtetuar rast pas rasti, do ju lutesha nëse keni durimin të shprehesh 5 minuta mbi disa konkluzione, që sigurisht nuk mund të janë vetëm administrative!

**Z. L. Braho:** Zoti Abazi, do të vijoni! Patjetër që do të vijoni, por lidhur me atë që ju thatë që të gjithë palët këtu kanë pritshmërinë që do ketë një vendimmarrje, pra rrëzim 3 me 2, ju bëj me dije se në fillim të seancës, të paktën palët, së publikun nuk e pyesim dot, të gjitha palët po i pyesim nëse kanë pretendime lidhur me konfliktin e interesit në raport me ndonjë nga anëtarët e KAS-it. Dhe deri tani në asnjë rast nuk është ngritur një pretendim i tillë! Kështu që besoj që ky diskutim i bërrë tashmë, pa u shoqëruar me një kërkësë të këtij lloj, nuk ka kuptim! Gjithsesi ju, si zoti Logu, si zoti Abazi, keni të gjithë të drejtën e mundshme që të shpreheni, por thashë pa etiketime në formën e fyres. Gjithçka tjetër, që ju lejon ligji në lidhje me pretendimet, patjetër jeni i lirë të merrni të gjithë kohën që ju duhet dhe të kërkoni në fund fare atë që ju prisni si rezultat i këtij shqyrtimi administrativ! Faleminderit!

**Zoti Bojken Abazi!** Absurdi në kuptimin muzikor lidhet me prishjen e harmonisë! në kuptimin logjik lidhet me zhvlerësimin dhe boshatisjen e akteve dhe veprimeve nga idealet! Këto seanca dëgjimore, i ngjajnë pjesëve të teatrit të absurdit, të cilat kanë një formë rrethore; pika e përfundimit është e njëjta me pikën e fillimit! Logjika dhe argumentet i lenë vendin përfundimeve irrationale, duke çuar në konkluzionin e pashmangshëm, -heshtje! ne depozitojmë ankesa të cilat rrezohen në tërësinë e tyre ende pa u trajtuar. Argumentet e provat nuk merren parasysh! As pamjet filmike të

*Zbardhi materialin audio*

*Aleksandër PRENGA*

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.05.2021*

numëruesve që vendosin X-a në fletët e votimit, nuk mjaftojnë! As fotografitë dhe fotot e manipuluara nuk merren parasysh! Mohohet ekspertiza mbi fletët e votimit të manipuluara! Mohohet marrja e informacioneve të tjera shtesë nga organet e tjera shtetërore! të gjitha këto bëhen me synimin që vendimi i marrë prej fillimit për ta rrezuar ankesën, pa marrë parasysh faktet dhe argumentet konfirmohet edhe në fund. Pra, që rrathi të marrë formën e plotë, si në teatrin e absurdit dhe të vendoset heshtja! Ndërkohë jashtë kësaj salle, ministri i brendshëm blendi çuçin, gjithashtu hesht prej 4 ditësh! Ai që kishte për detyrë ti mbronte zgjedhjet nga krimi elektoral, duket së ka komunikuar pikërisht me numëruesin që ka kryer krimin elektoral! Këtë ju e keni parë edhe në video. Ministri nuk jep asnjë shpjegim; nuk bën asnjë distancim; asnjë denoncim; dhe kështu, edhe ai tenton të vendosë heshtjen. Anëtarët e KAS-it që kanë vendosur prej fillimit ta rrezojnë ankesën tonë, pavarësisht fakteve dhe argumenteve, kanë një detyrë të vështirë nga ana morale, të mbrojnë absurdin! Në këto seanca është faktuar përtej çdo dyshimi se në Tiranë, dhe jo vetëm, ka ndodhur deformimi i vullnetit të qytetarëve, që ka ndikuar tek fitorja e pandershme dhe e jashtëligjshme, e së paku një mandati, mbase dhe më shumë, por së paku një mandati! Anëtarët e KAS-it, ata që kanë vendosur ta rrezojnë prej fillimit, të mbrojnë argumentin absurd së manipulimet dhe shkeljet ligjore në këto zgjedhje mbase duhen trajtuar nga organet e drejtësisë, por nuk duhen marrë parasysh si fakte që ndikojnë tek rezultati. Anëtarët e KAS-it, që kanë vendosur prej fillimit ta rrezojnë këtë ankesë, po përgatiten ta thonë në mënyrë absurde së vjedhja, blerja dhe manipulimi i votës nuk ndikon tek rezultati i zgjedhjeve; së përdorimi i jashtëligjshëm i fonave publike dhe i punësimeve në administratë, dhe së shkeljet e procedurave gjithashtu nuk ndikojnë tek rezultati. Pa bërë asnjë ekspertizë të mbi 18 000 votave të pavlefshme, duan të na thonë së ato janë gabime njerëzore dhe jo manipulime siç dëshmojnë videot dhe fotografitë. Duan të na thonë së s'ka rëndësi që ekziston një data bazë me të dhënat

*Zbardhi materialin audio*


*Aleksandër PRENGA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*  
*Dt. 27.05.2021*

e mbi 91000 qytetarëve të vjedhura, të bëra publike; që mbi 17 000 qytetarë në Tiranë të sëmurë me kovid, nuk iu mundësua nga KQZ-ja të votonin as në spitale e as në vendet ku ishin garantinuar. Anëtarët e KAS-it, që kanë vendosur prej fillimit ta rrezojnë këtë ankesë, pa marrë parasysh faktet dhe argumentet, janë duke bërë pjesën e banalitetit të së keqes që ka kapluar Shqipërinë. E keqja në këtë vend nuk rri në këmbë vetë! Ajo mbahet në këmbë përmes bashkëpunimit!

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga një numër zgjedhësish :** Zbatimin e urdhraive që bien ndesh me zbatimin e së drejtës dhe me ndërgjegjen tone. Unë i bëj thirrje ndërgjegjes suaj që të dalim nga banaliteti i së keqes, të thyhet ky rrethi i absurdit ku jemi futur dhe të fillojë të vendoset drejtësi duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe në Qarkun Tiranë, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Abazi, zonja Caka për pretendimet përfundimtare të palëve në cilësinë e subjektit të interesuar.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Ne në fakt nuk është se kemi patur një ankesë lidhur me Qarkun e Tiranës, por në suport të kolegut të Partisë Demokratike dhe njëkohësisht nisur edhe nga raporti që ka ardhur nga kryqëzimi i informacionit të dhënave të identifikimit elektronik për Qarkun e Tiranës, patjetër që suportojmë kërkesën ose ankimimin e bërë nga Partia Demokratike dhe bashkohemi edhe ne me kërkesën e shpalljes së pavlefshmërisë në fakt, në zgjedhjet në Qarkun e Tiranës sepse gjykojmë që jo 123 raste të dyshuara por qoftë edhe 1 rast po të kishte qënë nga... po të kishte rezultuar nga kryqëzimi i këtij informacioni, do të na tregonte shumë qartë që siguria e këtyre zgjedhjeve është cënuar dhe është cënuar rëndë, jo më 123 raste vetëm në Tiranë, apo edhe në qarqet e tjera. Kështu që shpresojmë që ju të merrni në konsideratë miratimin e kërkesës së shpalljes së pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Qarkun e Tiranës ashtu siç ishte dhe objekti i kërkesës së Partisë Demokratike, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zonja Caka! Besoj të njëjtën qasje keni edhe ndaj kërkesës së zotit Abazi, meqënëse dhe ai kërkon pavlefshmërinë .



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Patjetër, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Zoti Salianji?


**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Faleminderit! Vinë me dy kërkesa të pambështetura në ligj.

**Z.L. Braho:** Faleminderit që jeni kaq konçiz! Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim. Besoj për 30 minuta do të kthehem për të shpallur vendimin për Qarkun Tiranë dhe menjëherë do të nisim me shqyrtimin administrativ për Qarkun e Elbasanit, kështu që palët që janë, përveç zotit Abazi, të bëhen gati në lidhje me parashtrimet, faleminderit.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora: 11:57**


**Z. L. Braho:** Mirë atëhere riçelim seancën për çështjet që kanë të bëjnë me shqyrtimin administrativ të Kërkesave Ankimore nr. 39 dhe nr. 51 që kanë të bëjnë më tabelën e rezultateve për Qarkun Tiranë. Pasi KAS u mblodh në dhomë këshillimi, në përfundim të shqyrtimit administrativ të Kërkesave Ankimore nr. 39 dhe 51, bazuar në analizën e fakteve, të provave të administruara, mbështetur në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 143, të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash vendosi: Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 39, dt.09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni PD - AN. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 50, dt.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor kandidati i propozuar nga një numër zgjedhësish zoti Bojken Abazi. Lënien në fuqi të vendimit nr. 343, dt. 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve, për miratimin e tabelës përmbledhëse, për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet, në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi, faleminderit. Meqënëse sipas pritshmërive është seanca e fundit që relatohet prej meje, kisha dy falenderime, një për Administratën e KQZ-së dhe të dytën për mediat dhe gazetarët që në mënyrë të palodhur kanë ndjekur të gjitha këto seanca maratonë deri tani dhe besoj se do të vazhdojnë t'i ndjekin, faleminderit.

**Vendimi nr.91**



**27.05.2021  
Ora 15:00**

***RENDI I DITËS***

*Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr.43, datë 09.05.2021, të subjektit ankues PD-AN, dhe nr.48, datë 10.05.2021 të subjektit ankues Partia Lëvizja Socialiste për Integrin, për zonën zgjedhore Qarku Korçë".*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto.
- **Parti Politike:** PD, LSI, PS

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve fillojmë seancën e Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr.43, datë 9 Maj 2021 dhe nr.48, datë 10 Maj 2021, përkatësisht subjekteve zgjedhore PD-AN dhe të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrin me objekt të përbashkët “Kundërshtimin e vendimit nr.346, datë 04 Maj 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Korçë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluar në datën 25 prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Korçë, urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë këtë zonë zgjedhore. Fillojmë me legjitimimin procedural të palëve, është prezent përfaqësuesi i subjektit ankimes Partia Demokratike, është prezent gjithashtu

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

përfaqësuesi i subjektit tjeter ankimues Lëvizja Socialiste për Integrin. Zoti sekretar i përgjithshëm ka kërkesa të tjera procedurale për pjesmarrje?

**Z.Y.Merkaj:** Jo kërkesa e Partisë Socialiste dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrin janë nuk ka tjeter.

**Z.E. Çefa:** Lëvizja Socialiste për Integrin është ankues.

**Z.Y.Merkaj:** Është kërkesa e Partisë Socialiste.

**Z. E. Çefa:** Në proces si person i interesuar të Partisë Socialiste KAS i konsultuar në vend e pranon kërkesën për arsyen se Partia Socialiste ka një interes të ligjshëm në këtë vendimmarje. Përpara se të fillojmë nga palët ka ndonjë kërkesë procedurale paraprake?

**Z. M.Legisi, përfaqësues i PS-së:** Jo nuk kemi.

**Z.E. Çefa:** Nuk ka kërkesa nga anëtarët e KAS ndonjë kërkesë paraprake, ndonjë deklarim konflikt interesit? Nuk ka mund të fillojmë menjëherë me dëgjimin e palëve. Zoti sekretar i përgjithshëm po ja jap direkt fjalën avokatit meqënëse do të na i citoj ai të gjitha faktet për të cilat ka paraqitur ankim. Zoti Logu fjalën e keni ju.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 9 Maj 2021 PD-AN në cilësinë e subjektit zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka paraqitur pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve një kërkesë ankimore me objekt kundërshtimit e vendimit nr.346, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

zgjedhore Qarku Korçë duke kërkuar njëkohësisht pavlefshmérinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 prill në zonën zgjedhore Qarku Korçë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore. Ashtu siç besoj anëtarët e komisionit janë në dijeni në datën 25 Prill 2021, në zgjedhjet që u zhvilluan për Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore Qarku Korçë morrën pjesë në zgjedhje 131 mijë e 198 votues ose 46.14%, në datat 25 dhe 26 prill u krye numërimi i votave për subjektet zgjedhore, të cilat janë konstatuar 123 mijë e 812 fletë të vlefshme dhe 7 mijë e 375 fletë votimi të pavlefshme ose 5.62%. Mandatet në këtë zonë zgjedhore janë si vijon: Partia Socialiste 6 mandate dhe Partia Demokratike 5 mandate. Pas verifikimit paraprak që është kryer nga ana e ekspertëve ligjor dhe çështjeve zgjedhore të Partisë Demokratike janë konstatuar një sërë shkeljesh të cilat në vlerësimin tonë përmbushin kriteret ligjore të përcaktuar nga nen 160 dhe nen 161 i Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore pra në Qarkun Korçë dhe po ashtu për urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve të cilat do të relatohen në mënyrë të përbledhur si vijim pasi besojmë që nga ana e relatorit të çështjes por edhe anëtarëve të tjerë të komisionit janë njojur me kërkesën tonë ankimore dhe provat bashkëlidhura saj. Sa i përket fenomenit të blerjes së votës e cila po ashtu kemi pasur mundësi ta themi edhe në fillimin e shqyrimit të këtyre seancave që nga ana jonë janë vërejtur shkelje me tipologji të ngjashme ku një ndër to sigurisht është dhe blerja e votës e përhapur dhe në 9 qarqet ku ne kemi depozituar kërkesat tona ankimore, i cili si fenomen është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit me drejtues politik të Partisë Socialiste qofshin këta drejtues politik të qarkut, qofshin kandidatë për deputet, apo ministra të cilët kanë qenë në këtë zonë. Konkretnisht sa i përket Qarkut të Korçës në Bashkinë e Pogradecit ka qenë kandidate për deputete zonja Blerina

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

Gjylameti e cila është aktualisht deputete e Kuvendit të Shqipërisë, në fushatën e saj është përfshirë në fakt një shtetas me rekorde të theksuara kriminale dhe me lidhje të shumëfishta me krimin e organizuar, konkretisht shtetasi Denis Mlaceri, i cili është dënuar disa herë për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike dhe substanca psikotrope. Nga ana tjetër ky shtetas ka në disponim të tij ose zotëron dhe shpërndarje një kompanie transporti të quajtur Shoqëria Bois Katrans nëpërmjet të cilës ka kryer një sërë aktivitetesh abuzuese me qëllim ndikimin e vullnetit të zgjedhsve në zgjedhjet e 25 prillit. Po ashtu në veprime të cilat bien në kundërshtim të qartë me nenin 78 të Kodit Zgjedhor pra me fenomenin e shitblerjes së votave është përfshirë dhe Kryetari i Bashkisë Pogradec shtetasi Ilir Gjakolli. Nga ana e Partisë Demokratike siç kemi pasur mundësi të relatojmë dhe më herët janë kryer një numër i konsiderueshëm kallëzimesh penale qofshin këto në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar rrëth 50 kallëzime penale qofshin këto në Prokurorinë e Juridikisionit të Përgjithshëm 130 kallëzime penale. Sa u përket kallëzimeve të kryera në Qarkun e Korçës kemi 3 kallëzime penale, konkretisht 2 kallëzime janë kryer në datën 2 Prill 2021 dhe një kallëzim është kryer në datën 15 prill 2021. Në datën 2 prill 2021 është kallëzuar penalisht në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit e Krimtit të Organizuar shtetasi Jani Andoni në funksion Nënkyetar i Bashkisë Pustec për veprat penale të dhënies së shpërblimeve dhe pretimeve, ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, sepse ky i fundit kërcenonte gjimnazistët dhe mësuesit në Bashkinë Pustec që do të anullonte apo nuk do të jepte bursa studimi në Shtetet e Bashkimit European konkretisht në shtetin bullgar në qoftë se mbështetja e tyre nuk ishte për Partinë Socialiste dhe nuk angazhoheshin me fushatën e kësaj partie. Po ashtu në datën 2 Prill 2021, është kallëzuar pranë Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

dhe Krimtit të Organizuar shtetasi Kletion Kita Nënkyetar i Bashkisë Korçë dhe shtetasi Ilir Baljozi Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal duke konsumuar veprat penale të dhënes së shpërblimeve ose premtiveve dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Së treti në datën 15 prill 2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar në SPAK shtetasit Niko Peleshi me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministër i Mbrojtjes kandidat për deputet i renditur i 6-i në listën shumemërore të Qarkut Korçë dhe drejtues politik i Partisë Socialiste për këtë qark shtetasin Sotiraq Filo Kryetar i Bashkisë Korçë dhe shtetatin Artan Lame Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të ciëlt me veprimet e tyre kanë konsumuar vepra penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, shpërdorimit të detyrës dhe përdorimit të funksionit publik për veprimtari zgjdhore. Nga ana tjetër po ashtu nga ana e strukturave të Partisë Demokratike për të cilat janë kryer dhe denoncimet përkatëse në organet ligjzbatuese, janë konstatuar një sërë rastesh kur eksponentë të Partisë Socialiste dhe persona me rekorde të rënda kriminale janë kapur në flagrancë në shkelje të ndryshme të ligjit. Patëm mundësi të relatojmë më herët rastin kur Nënkyetari i Bashkisë Pustec kërcënonte në mënyrë të drejtpërdrejt studentët me anullimin e bursave të studimit ose mosdhënien e tyre në qoftë se këta të fundit do refuzonin të votonin apo mbështesnin në fushatë të hapur Partinë Socialiste. Ndërkohë që rast tjetër është edhe fakti i shtetasë Besa Spaho, e cila ishte kandidate e Partisë Socialiste në Qarkun Korçë dhe me detyrë Drejtore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Korçë e cila premtonte legalizime baneshash dhe favoresh të tjera në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Për këtë shtetase Partia Demokratike në përputhje me nenin 283, të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

Kodit të Procedurës Penale ka bërë në datën 2 Prill 2021, një kallëzim penal në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë. Të gjitha rastet e mësipërme të cilat ne kemi pasur mundësi t'i analizojmë në mënyrë të detajuar në faqen 4, 5 dhe 6 të kërkesës sonë ankimore por që për efekt kohe nuk po i citoj në mënyrë të dertajuar besoj që provojmë plotësisht ka provat dhe fakte që ne i kemi vënë në dispozicion këtij komisioni se dhe në Qarkun Korçë procesi apo fenomeni i blerjes së votës ishte një nga problematikat kryesore që karakterizoi zgjedhjet e 25 prillit në këtë qark. Po ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë dhe të parashtrojmë edhe për qarqet e tjera edhe në Qarkun e Korçës procesi zgjedhor i zgjedhjeve të 25 prillit u shoqërua jo vetëm me fenomenin e dhënies së parave përkundrejt votave në zgjedhjet e 25 prillit, por edhe dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera, të cilat sigurisht kishin për qëllim manipulimin apo tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve. Në faqen 7 të kërkesës sonë ankimore kemi cituar disa vendime të Këshillit të Ministrave, po ashtu disa vendime të Organeve Lokale të Qarkut Korçë konkretisht të Këshillit Bashkiak Korçë, të cilat kishin për qëllim dhënien e përfitimeve financiare për kategori të caktuara shoqërore mëe qëllim ndikimin ose manipulimin e vullnetit të tyre e cila sigurisht në vlerësim të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor është një veprimtari e ndaluar është tërësisht e ndaluar nga ligji pasi Kodi Zgjedhor ka ndaluar në mënyrë të shprehur që në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve organet qëndrore apo organet vendore të nxirrin akte ligjore apo nënligjore si sjellin përfitime për kategori të caktuara shoqërore përvçese kur ato diktohen nga nevoja të ngutshme çka nuk është rasti në ato vendime që ne kemi cituar në kërkesën tonë ankimore. Nga ana tjetër siç kemi pasur mundësi të relatojmë edhe herët në kërkesat e tjera edhe në Qarkun Korçë pati një fenomen të përhapur në mënyrën masive ku të gjitha investimet publike që u kryhen në Qarkun Korçë në këtë periudhë qoftë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

nga Pushteti Qendror apo Pushteti Vendor u përdorën me qëllim për t'i vënë në shërbim të fushatës elektorale të Partisë Socialiste. Ky është një fakt i cili është thënë jo vetëm nga ana jonë dhe denonuar në mënyrë të përsëritur, por një fakt gjithashtu i konstatuar në raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it kam parasysh këtu citimet që janë në faqen 2 dhe 12 të këtij reporti ku flitet vazhdimit përvizita të rregullta që kryejnë zyrtarët drejtues, Ministra të Partisë Socialiste me qëllimin e vetëm që të ndikonin tek vullneti i zgjedhësve në zgjedhjet e 25 prillit. Po ashtu si dhe në qarqet e tjera kemi pasur mundësi të relatojmë dhe të parashtrojmë gjerësisht përfshirë faktin që sot patëm sot dhe të relatojmë për Qarkun e Elbasanit dhe ndoshta për të shmanjur përsëritjet e panevojshme. Edhe në Qarkun e Korçës janë konstatuar një përdorim masiv i punonjësve të administratës shtetërore për t'u angazhuar në fushatën elektorale të Partisë Socialiste përkundrazi të gjendeshin përballë presioneve kërcënimeve për t'u larguar nga detyra. Konkretisht kjo është një gjë që qëndron edhe për qarqet e tjera nëpunësve të niveleve të ulëta dhe të mesme iu janë kërkuar që të sjellin lista me familjarë të tyre 30 deri në 50 votues. të sjellin karta identiteti të marrin pjesë në fushatë, të shpërndajnë postime në rrjetet e tyre sociale një sërë aktivitetesh të tjera të cilat në vlerësimin tonë vijnë tërësisht në kundërshtim me nenin 78 të Kodit Zgjedhor. Po ashtu kemi paraqitur raste të ndryshme po ndoshta një nga rastet të cilat vlen për t'u cituar në këtë moment është fakti që Drejtori i Rezervave të Shtetit në Qarkun e Korçës shtetasi Gëzim Spaho, kërcënonët vazhdimit administratën që të sillnin pranë kësaj drejtorie kartat e identitetit të punonjësve të afërmve të tyre, të cilët ishin evidentuar si votues të djathtë me qëllim këta të fundit të pengonin ushtrimin e të drejtës së votës. Pra kartat e identitetit nuk përdoreshin thjesht dhe vetëm që më pas të kryhej votimi i shumëfishtë apo shkeljet e tjera ligjore që janë denonuar nga ana jonë por

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

përdoreshin edhe për qëllime për t'iu ndaluar apo penguar zgjedhës të Partisë Demokratike apo të opozitës për të votuar në zgjedhjet e 25 prillit që është një fenomen i konstatuar masivisht. Po ashtu kemi pasur mundësi të relatojmë në kërkesën tonë ankimore sesi fakti që Partia Socialiste kishte të gjithë pushtetet qendrore dhe vendore përdorin shpeshherë intimidimet dhe presionet nëpërmjet gjabave të inspektorateve të ndryshme për të penguar zhvillimin e aktiviteteve të Partisë Demokratike. Kam parasysh këtu faktin që drejtues dhe përfaqësues të lartë të opozitës u gjabitën për shkak të aktiviteteve të tyre zgjedhore ndërkokë që i njëjti standart nuk u zbatua në rastin e përfaqësuesve të Partisë Socialiste. Në kërkesën tonë ankimore të nderuar anëtarë të komisionit kemi relatuar dhe parashtruar gjerësisht edhe punësimet që u kryhen në administratën publike, të cilat sigurisht kishin për qëllim që të tjeteronin dhe manipulonin vullnetin e zgjedhësve edhe kjo në vetvete një veprimtari e ndaluar nga neni 91 i Kodit Zgjedhor që sigurisht ndalon punësime që kryhen në Administratën Publike 4 muaj përpara zgjedhjeve përvçe se kur ato diktohen në nevoja të ngutshme dhe mendojmë që 13 mijë punonjës dhe vetëm 4 muaj në dijeninë tonë më të mirë nuk ka pasur ndonjë nevojë të ngutshme që i ka diktuar këto punësime. Jemi të bindur që dhe kemi parashtruar dhe raste konkrete po themi në rastin e punonjësve të Administratës së Qarkut Korçë kemi pasur 200 pozicione, kemi pasur 120 pozicione në Bashkinë Pogradec, 42 pozicione të reja në Bashkinë Devoll dhe pozicione të reja në Pustec, 26 pozicione të reja në Bashkinë Korçë, të gjitha këto në vlerësimin tonë janë pozicione pune që janë përdorur për qëllime elektorale dhe është fakt publik i publikuar nga Ministria e Financave që në periudhën Janar-Prill 2021 janë paguar paga rrëth 63 milionë euro më shumë se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm. Po ashtu në kërkesën tonë ankimore si një shkelje e rëndë e ligjit duke qenë se kemi të bëjmë me përdorimin burimeve

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

publike kemi relatuar ose parashtruar dhe faktin që lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdoren masivisht për të ndikuar mbi vullnetin e zgjedhësve konkretisht në këtë veprimtari e cila është kallëzuar nga ana jonë edhe në prokurori u përfshijnë shtetasit Niko Peleshi, Sotiraq Filo dhe Artan Lame, të cilët në mënyrë të përsëritur premtonin dhe shpërndanin leje legalizimi në këmbim të votës. Nga ana tjetër ne kemi denoncuar edhe një rast që mendojmë që është mjaft flagrant dhe mjaft domethënës për këtë proces sesi vetëm në fshatin Vërsnik janë premtuar dhe shpërndarë rrëth 400 leje legalizimi dhe më pas certifikata pronësie në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Më gjerësisht faktet të cilat sapo relatova janë edhe në pjesë të provave që ne kemi depozituara e konkretisaht kallëzimit penal që Partia Demokratike ka kryer pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 15 Prill 2021. Po ashtu të nderuar ne mendojmë dhe ndoshta këtu nuk do të doja të ndalesha të ndalesha shumë, sepse kemi pasur mundësi që t'i relatojmë dhe në kërkesat tonë ankikmore faktin e përdorimit të vjedhjes dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale që po ashtu e konsiderojmë të rëndë për çdo qark në fakt dhe kudo që kjo është paraqitur mohimin e të drejtës për të votuar të 500 mijë shtetasve shqiptarë që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut, besojmë që kjo është veçanërisht sensibël për Qarkuin e Korçës ku ka po themi të dhëna të cilat duhet të konfirmohen zyrtarisht nga institucioni që jetojnë një numër më i madh shtetasish shqiptar të cilët efektivisht jetojnë dhe punojnë në shtetin grek. Po ashtu mohimin e të drejtës për të votuar të infektuar me Covid-19, numrin e madh të fletëve të votimit të cilat siç pata mundësi t'i citoj dhe në hyrje të këtyre parashtrimeve janë mjaft domethënëse e veçanërisht në Qarkun e Korçës ku ka një diferencë të ngushtë për mandatin e deputetit, veçanërisht për mandatin e parë të deputetit të Lëvizjes Socialiste për Integrim, por duke qenë se koleget e

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

Lëvizjes Socialiste janë të pranishme besoj që do të kenë mundësinë të parashtronjë në mënyrë më gjerë këtë fenomen. Ndërkohë së fundmi ashtu siç edhe në qarqe të tjera ne kemi pasur informacione të besueshme për raste të shumfishta të votimit nga ana e të njëjtëve zgjedhës për votim për të tretë apo votim familjar të cilat sigurisht do të duhen që të verifikohen ose do të duhen që të përqasen me të dhëna që ne do marrim nga kryqëzimi i të dhënave PEI. Pasi të kemi edhe këto të dhëna besoj që do të kemi një panoramë më të qartë se çfarë ka ndodhur në vetvete me këtë problematikë. Në një konkluzion paraprak se sigurisht për konklusionet përfundimtare do të rezervojmë të drejtën tonë në përfundim të shqyrtimit administrativ. Ne të nderuar anëtarë të komisionit, vërejmë se dhe në Qarkun e Korçës ka pasur raste të përsëritura, raste të rënda të blerjes së votës, përdorim masiv të burimeve dhe aseteve publike, përdorim të paligjshëm të të dhënave personale, ndalim të drejtës së emigrantëve për të votuar, ndalim i të ifnetktuarve me Covid-19 për të infektuar. Një numër relativisht i lartë dhe i konsiderueshëm me vlerë domethënëse të fletëve të votimit të pavlefshme raste të votimit të shumfishtë qoftë dhe ai votim për të tretë, familjar apo rastet kur kartat e indetitetit të zgjedhësve janë përdorur për të votuar i njëjtë person, të cilat në tërësinë e tyre në vlerësimin tonë përbushin kushtet e kërkua nga kriteret ligjore të kërkuar nga neni 160 sa i përket shpalljes së zgjedhjeve të pavlefshme jo vetëm në një qendër votimi, po në gjitha qendrat e votimit të Qarkut Korçë dhe sigurisht në të gjithë zonën zgjedhore e në përputhje me nenin 161, urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në këtë qark. Kaq për këtë pjesë besoj që pasi të kemi mundësi të diskutojmë edhe mbi provat që kemi depozituar dhe prova që kërkojmë do të mund të ndërtojmë po themi disa konkluzione përfundimtare më të plota për sa i përket ankimit që kemi paraqitur për Qarkun Korçë, faleminderit për vëmendjen.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

**Z.E. Çefa:** Faleminderit avokat fjalën e ka përfaqësuesja e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrin.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit në fakt kërkesa jonë ose ankimimi ynë është në të njëjtin vazhdë me Qarkun e Vlorës edhe të Gjirokastrës, të cilat sigurisht u rrëzuan nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. Sigurisht edhe Qarku i Korçës ka qenë tërësisht i prekur nga një fenomen ose nga një urdhër ministri i cili në gjykimin tonë është tërësisht i paligjshëm dhe mbi të gjitha antikushtetues, i cili sigurisht ndikoi në pjesmarrjen por njëkohësisht në rezultatin por edhe në konfigurimin e mandateve në Qarkun e Korçës. Mund t'iu kujtoj se dhe me urdhërin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojteve Sociale nr.219 të datës 19 prill 2021, u vendos karantina dyjavore e shtetasve shqiptar që vinin nga Greqia apo nga Maqedonia e Veriut. Bazuar në nenin 3 dhe 17 të Kushtetutës besoj që të gjithë e dijmë që është mohuar e drejta kushtetuese të gjithë qytetarëve shqiptarë për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar apo për të zgjedhur. Kjo masë e propozuar dhe e marrë 4 ditë përpëra datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë provoi në fakt se vendimmarrja propozues i Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe akti miratues i Ministres së Shëndetësisë ishin akte të fromësuara nga një vullnet jo objektiv dhe aq më tepër jo mjeksor por tërësisht politik dhe që solli si pasojë direkte negative pengimin e këtyre qytetarëve për ushtrimin e të drejtës së votës. Një akt i tillë në gjykimin tonë në situatën konkrete ku ne ndodhemi jo vetëm që ka penguar emigrantët shqiptarë të hyjnë nga Republika e Shqipërisë dhe ajo e Maqedonisë së Veriut, por për nga mënyra sesi ka nisur implementimi i tij dhe këtu do të doja që të ndalesha pak përmes detyrimit për të nënshkruar një formular dhe për t'u vetkarantinuar për 14 ditë pa marrë në konsideratë as rastet kur shtetasit

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

paraqitnin përpala autoriteteve testin e kryer PCR, apo çdo test laboratik tjetër që vërteton negativitetin ndaj virusit Covid-19. Gjykojmë që ky urdhër ka cënuar rëndë garancitë kushtetuese të shtetasve për të hyrë në territorin dhe atdheun e tyre dhe për të ushtruar të drejtën kushtetuese të votës. Në vijim edhe procesi i votimeve në Qarkun e Korçës ka qenë i cënuar në thelb pasi është cënuar e drejta kushtetuese e votuesve shqiptarë të cilët kanë qenë të regjistruar në listën e zgjedhësve të Qarkut Korçë dhe nga ky akt i paligjshëm janë penguar në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të votës. Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që Qarku i Korçës është një nga qarqet më të prekura nga largimi i shqiptarëve dhe kryesisht drejt shtetit fqinj meqënëse janë një nga qytetet më kufitare me shtetin e Greqisë po të mos harrojmë që është dhe një tjetër bashki në Qarkun e Korçës e cila është e prekur kryesisht nga shtetas shqiptar të cilët jetojnë në Maqedoninë e Veriut dhe është pikërisht Bashkia e Pustecit. Duke u referuar statistikave që vetë mund të gjenden shumë kollaj dhe në faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, domethënë ky urdhër ka ndikuar padiskutim edhe në pjesmarrjen e këtyre qytetarëve dhe të mos i harrojmë dhe rezultatet e zgjedhejve të mëparshme të paktën 10 vitet e fundit dhe është që ka pasur si qëllim për të sfumuar edhe për të dëmtuar vetëm një subjekt politik që është pikërisht Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Orientimi politik u pa qartë edhe në anullimin në datën 3 Maj 2021 të këtij urdhëri poltik pikërisht pak ditë pas përfundimit të zgjedhjeve. Vendosja e masave të tillë në gjykimin tonë pak ditë përpala ditës së votimit dhe heqja e masave pak ditë pas përfundimit të procesit të votimit dëshmon për një vullnet të orientuar politikisht duke penguar shtetasit shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedonië e Veriut ushtrojnë të drejtën kushtetuese të votës. Gjithashtu duhet theksuar se edhe pse nuk kishte dalë ende një akt zyrtar rregullues nga Këshilli i Ministrave apo Ministrja e Shëndetësisë mbi masat e

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

karantinimit dy favor për shtetasit që vinin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut duket se vet mbi bazën njoftimit publik pra pa u bërë praktikisht ky urdhër zyrtar dhe pa marrë fuqi duke u publikuar në fletoren zyrtare. Autoritet policore si në datën 20 ashtu edhe gjatë datës 21 sepse ju kujtoj që ky urdhër ka hyrë në fuqi në orët e vona të datës 21, në pikën kufitare me Greqinë kërkonin prej qytetarëve plotësimin e formularëve për vetkarantinim ndërkohë që në fletoren zyrtare ende nuk ishte botuar një akt i Autoritetit Kompetent me fuqi juridike përkundrejt pasojave të tij rregulluese apo urdhëruese. Akti është publikuar në fletoren zyrtare vetëm në datën 21 prill në orët e vona të pasdites kur dy ditë pas njoftimit publik nga Komitetit Politik i Ekspertëve dhe kjo vonesë ka ndodhur pavarësisht pasojave dhe efekteve që ai sjell të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në lëvizjen e lirë dhe në mospjesmarrjen e këtyre shtetasve në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit. Ende pa u botuar akti në fletoren zyrtare, shtetasve shqiptarë në kufi që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë u kërkohej nënshkrimi i një formulari me detyrim për vetkarantinim 14 ditor dhe kjo kërkesë ka ardhur mbi bazën e një akti që ende nuk kishte hyrë në fuqi, pasi sipas nenit 117 të Kushtetutës, pika 1, akti merr fuqi juridike vetëm pasi i bëhet i ditur botërisht përmes votimit në fletoren zyrtare. Gjithashtu statisitikat e mësipërme janë publike dhe janë një tregues mjaft i qartë se pse urdhri i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.219, ka pasur qëllim të godasë drejtpërdrejt subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, ky fakt reflektohet edhe në rezultatin zgjedhor të sipërcituar dhe vlen të theksojmë gjithashtu faktin se rezultatin zgjedhor në Bashkinë e Pustecit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në rezultatin e përgjithshëm të Qarkut Korçë, pasi në një situatë eventuale të mospengimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë në Maqedoninë e Veriut dhe Greqi të pjessmarrjes në votime, shpërndarja dhe konfigurimi i

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

mandateve në Qarkun e Korçës do të ishte ndryshe. Në cilësinë e suportit ndaj ankesës sonës por njëkohësisht edhe të provave do të doja që t'ju citoja vet faktin që disa shoqata emigrantësh, të cilët janë përfaqësues të Shoqërisë Civile bën një apel për heqjen e këtyre masave në suprot të kësaj kemi dhe institucionin e Presidentit të Republikës si autoriteti dekretues i datës së Zgjedhjeve dhe jo vetëm kaq po dhe garantues i të drejtave kushtetuese të shtetasve shqiptarë me banimin brenda apo jashtë vendit përmes shkresës nr.1413, datë 20 Prill 2021, i është drejtuar Këshillit të Ministrave, Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komitetit Teknik të Ekspertëve, Organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtorisë së Përgjithshme së Policisë Shtetit, Kuvendit të Republikës por dhe Avokatit të Popullit dhe të gjitha përfaqësive të huaja dhe të gjitha partive garuese ku kërkojmë marrjen e masave urgjente lidhur me heqjen e pengesës për ushtrimin e së drejtës për të votuar nga ana e emigrantëve shqiptarë që kthehen në Shqipëri nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut, duke theksuar edhe një herë pasoja direkte që ka një masë e tillë jo proporcionale në ushtreimin e të drejtës themelore për të votuar nga ana emigrantëve shqiptarë. Një tjetër kundërshtim ndaj këtij urdhëri ishte pikërisht shkresa nr.242, i datës 21 prill e Avokatit të Popullit drejtuar Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komitetit të Përkohshëm për infekzionin e hapur nga Corona virus i ri, paraqiti rekomandimin për anulimin tërësisht dhe menjehere të urdhërit nr.219, datë 19 prill 2021, për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia. Në vijim edhe procesi i votimeve në Qarkun Korçë ka qenë i cënuar në thelb pasi është cënuar e drejta ksuhetuese e votuesve shqiptarë me banim në Greqi, të cilët kanë qenë të regjistruar në listën e zgjedhësve të Qarkut Korçë dhe janë penguar në ushtrimin e të drejtës së tyre kushtetuese të votës. Për të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

vlerësuar impaktin e këtij urdhri në procesin zgjedhor të Qarkut Korçës mjafton të marrim një analizë rezultatin e pjesmarrjes në zgjedhjet e 10 viteve të fundit në raport me pjesmarrjen në zgjedhjet për Kuvendin në vitin 2021 nga ku rezulton qartë se kemi një numër më të ulët të pjesmarrjes. Pikërisht këto statistika referuar dhe faqes online të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë një tregues mjaft i qartë se pse urdhri i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka pasur qëllim të godasë politikisht subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrin. Në vijim të këtyre pak provave që përmendëm por dhe njëkohësisht duke iu referuar edhe çfarë kemi deklaruar qoftë dhe për Qarkun e Vlorës ashtu dhe për Qarkun e Gjirokastrës, ne jemi në situatën ku kjo vendimmarrje është tërësisht politike, tërësisht e orientuar dhe ka vetëm një qëllim që është pikërisht për të mos u bërë ipetitive por ka vetëm një qëllim për të dëmtuar mandatin e Lëvizjes Socialiste për Integrin, i cili në çdo zgjedhje ka qenë i sigurtë dhe shumë i qartë për Lëvizjen Socialiste për Integrin në Qarkun e Korçës dhe ato që unë përmenda pak më parë sigurisht dhe në cilësinë e provës dhe në përfundim ne i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndryshimit e vendimit të Komisionerit nr.346, datë 4 Maj 2021 “Për miratimin e tabelës përbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, shpalljen e pavlefshmërisë së zgjehjeve në këtë qark dhe njëkohësisht urdhërimin e përsëritjes së zgjedhejve në Qarkun Korçë, falemidnerit.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit përfaqësuesi i Partisë Socialiste në qoftë se keni ndonjë gjë?

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankstioneve  
Dt 27.05.2021*

**Z.M.Legisi, përfaqësues i PS-së:** Faleminderit zoti kryetar, në mënyrë të përbledhur ne kërkojmë që në bazë të nenit 30, pika 1, germa "b", e vendimit nr.3, të vitit 2020 të Komisionit Rregulator, kérkesat nr.43 dhe 48 të rrëzohen si të pabazuara në ligj e në prova. Kërkimi për pavlefshmérinë në zonën zgjedhore të çfarë do lloj qarku është i paparashikuar nga ligji zgjedhor dhe ligji zgjedhor pikërisht në nenin 160 parashikon pavlefshmérinë e zgjedhjeve në qendrën e votimit dhe për shkak të shkeljeve të ligjit të një apo disa shkeljesh apo shumë shkelje të ndodhura në ato qendra votimi dhe kërkon arsyetim të detajuar për pasojën e tyre. Po ashtu edhe vendimi nr.3 i Komisionit Rregulator datë 06.11.2020, e parashikon që në kérkesë do të përcaktohen qendrat e votimit nga relativi i fakteve nuk u referua në asnjë qendër votimi sesi këto fakte ngjarje të pretenduara përveç të paprovuara kanë ndikuar në shkeljen e ligjit çka pason në pavlefshmérinë e zgjedhjeve. Për sa më sipër zoti kryetar, ne vlerësojmë që kérkesat ankimore janë të pabazuara në ligj e në provë dhe duhet të rrëzohen si të tilla, faleminderit.

**Z. E. Çafa:** Faleminderit përpara se të kalojmë në administrimin e provave apo ndonjë kérkesë tjeter në lidhje me provat nga subjektet pjesmarrëse, nga palët në ankim, nga kolegët ndonjë pyetje për këtë fazë? Jo nuk kemi. Atëherë mund të kalojmë në citimin në mënyrë të përbledhur të provave apo parashtrimin e provave të paraqitura në KAS dhe atyre që eventualisht do të mund të kërkohen duke filluar nga përfaqësuesi i subjektit PD-AN.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës, provat që ne i kemi bashkëlidhur kérkesës sonë ankimore nr.45, janë të cituara në faqet 55, 56 dhe 57 të kérkesës sonë ankimore, të cilat patëm mundësi t'i përmendim në

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

mënyrë të përbledhur edhe gjatë parashtrimeve tona, në qoftë se ju e vlerësoni të nevojshme që t'i citojmë provë pas prove ne jemi gati. Në qoftë se dhe koha mendoni se nuk është e nevojshme mjafton fakti që i keni të cituara në mënyrë të detajuar në faqet 55, 56 dhe 57.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit unë besoj që nuk ka nevojë që t'i citojmë, janë rreth 45 prova të cituara në faqen 55 deri në 57 të materialit tuaj kështu që unë besoj ne jemi të gjithë një mendje dhe për ekonomi të shqyrtimit administrativ mund të vijojmë me kërkesa të tjera sërisht lidhur me prova. Po avokat.

**Z.M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po ashtu i nderuar kërkesat tona për prova janë të cituara në faqen 49,50 dhe 51 të kërkesës sonë ankimore. Janë në total 19 kërkesa, 18 prej të cilave kanë të bëjnë me marrjen e informacioneve pranë organeve të Administratës Publike në përputhje me nenin 137 të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë që një provë ka të bëjë me marrjen e të dhënave të kryqëzuara të pajisjeve PEI në përputhje me nenin 136 të Kodit Zgjedhor. Në qoftë se nga ana e komisionit vlerësohet e nevojshme që t'i citojmë të gjitha një pas një mund ta bëjmë. Në qoftë se për ekonomi të shqyrtimit administrativ mendoni që mjafton fakti që janë të cituara 49 deri në 51 të kërkesës sonë ankimore mund të vazhdojmë me kolegët e subjekteve tjera, faleminderit.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit avokat nuk ka besoj kërkesa për t'i cituar një nga një kështu që mund të vijojmë me përfaqësuesn e LSI-së.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit atëherë provat tona citohen në faqen 7 të ankimimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe meqënëse janë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

praktikisht 1/9 të kolegut të Partisë Demokratike, unë do të doja t'i citoja janë shumë shkurt. Pikërisht është vendimi nr.346 i datës 04 Maj të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është rekomandimi i Avokatit të Popullit nr.242, datë 21 Prill 2001(2021), pyetësor tip i Ministrisë së Brendshme për shtetasit që kthehen nga zonat e prekura nga virusi Covid-19, peticioni i Shoqatave të Emigrantëve në Greqi dhe njëkohësisht është dhe letër e institucionit të Presidentit të Republikës nr.1413/2, e datës 22 prill 2021, faleminderit.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit përpara se të kalojmë te pyetjet rreth provave përfaqësuesi i Partisë Socialiste, keni për të thënë diçka lidhur me vlerësimin e provave deri në këtë fazë?

**Z.M.Legisi, përfaqësues i PS-së:** Jo nuk kemi.

**Z. E. Çefa:** Atëherë do të kalojmë në pyetje po e filloj unë kam dy sqarime besoj krejtësisht të shpejta, të cilat dëshiroj të m'i japë përfaqësuesja e LSI-së. Në themel të ankimit tuaj qëndron kryesisht urdhri për karantimin e personave që vijnë nga Maqedonia e Veriut dhe nga Greqia. Efekti që ky urdhër ka pasur potencialisht sipas jush në elektoratin kryesisht të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrin. Tani në qoftë se do të mundeni të m'i thoni në këtë seancë për ta kupuar më mirë edhe këtë impakt dhe për të gjykuar ndoshta. Do të më kishin shërbyer disa shifra pra referuar statistikave nga zgjedhjet e kaluara und të më thoni sa votues ka pasur Partia Lëvizja Socialiste për Integrin në zgjedhjet e fundit mundësisht edhe të tjerat për Kuvendin dhe sa kishte në këto zgjedhje të datës 25 prill, nëse e keni këtë. Pyetja tjetër në vijim që mos t'ua ndërpres më

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

fjalën sa është diferenca e votave që do të bënte të mundur që Partia Lëvizja Socialiste për Integrim të merrte mandatin në zonën zgjedhore Qarku Korçë?

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit në irradhë të parë do t'ju kërkoja vetëm pak kohë për të verifikuar edhe një herë për shkak të inkoherençës së shifrës së vitit 2017, nëse është e mundur sepse nuk e kam një tabelë.

**Z. E. Çefa:** Sa kohë ju duhet se nuk është e domosdoshme mund ta gjejmë edhe ne pak më vonë.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Nëse mund ta gjejë Administrata e KQZ-së, thjesht një numër të votave të Lëvizjes Socialiste për Integrim në vitin 2017. Gjykoj që ka qenë diku 13 mijë e diçka po nuk e kam të saktë shifrën.


**Z. E. Çefa:** Ne do ta marrim rezervë këtë shifër dhe mund ta verifikojmë dhe ne më pas në fazat e tjera.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Në mos qofsha unë e gabuar, më duket se ka qenë 19 mijë.

**Z. E. Çefa:** Pra 19 mijë ka qenë shifra.. administrata në qoftë se do të mundet edhe më pas mund të na jepni ne këtë shifër, faleminderit. Po diferenca për mandatet?

*Zbardhi materialin audio*

*Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Po nëse nuk kam shifër e vitit 2017 nuk mudn ta kem të qartë diferencën, megjithatë pak rëndësi ka...

**Z. E. Çefa:** Më fal e kisha fjalën për diferenca e votave pra sa vota u duhej subjektit që ju përfaqësoni që të merrte mandatin në këto zgjedhje?

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Diferenca ka qenë më e vogël se 2500 dhe duhet të kemi në konsideratë diçka që Qarku i Korçës në disa prej bashkive në zgjehdjet<sup>5</sup> qoftë në zgjedhje vendore ashtu dhe në zgjedhjet qendrore në Qarkun e Korçës, Lëvizja Socialiste për Integrim ka pasur dhe bashki ku ka rezultuar që të jetë forcë e parë siç ka qenë Bashkia e Ersekës apo dhe në Bashkinë e Pustecit ku ka pasur një numër shumë të konsiderueshëm votash, është pak a shumë e njëjta skemë siç është ndjekur edhe me zonën e Dropullit në Gjirokastër. Pra janë sulmuar pikërisht bashkitë ku Lëvizja Socialiste për Integrim në zgjedhjet paardhëse si vendore ashtu edhe qendrore ka pasur një numër të konsiderueshëm votuesish, të cilët sigurisht me urdhrin e Ministrisë janë penguar që të marrin pjesë në këto votime dhe është shumë e qartë arsyaja është pikërisht penalizimi dhe privimi i këtyre qytetarëve për të ushtruar të drejtën e tyre për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Nuk dua ta bëj në formë debati por lidhur me atë që tha përfaqësuesi i Partisë Socialiste ne nuk mund të kërkojmë pavlefshmëri vetëm në disa qendra. Nëse Kodi Elektoral kërkon ose të lejon që të kërkosh pavlefshmërinë në një qark të tërë apo në një zonë të administrimit zgjedhor nuk ka pse edhe për ekonomi por edhe për non sens, mendoj unë qoftë ligjor qoftë shkresor që ne tani të rrijmë dhe të përmendim të gjitha qendrat e votimit që ka Qarku i Korçës. Për aq kohë sa kërkojmë pavlefshmërinë në një qark të tërë mendoj unë të paktën këtu nuk është e nevojshme të përmendim

*Zbardhi materialin audio*

*Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

qendra votimi as Bashkisë Pustec meqënëse ka qenë si bashkia më e prekur të paktën nga urdhëri i Ministres së Shëndetësisë, po as Qarku i Korçës në tërësi i cili siç e përmendëm dhe pak më parë dhe siç botërisht dihet që është një nga qarqet më të prekura nga qytetarët shqiptarë të cilët janë rezident ose në Maqedoninë e Veriut ose në Greqi, faleminderit.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit juve, po avokat më kërkua fjalën.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Vetëm një saktësim po themi meqënëse i kemi të dhënat, diferencën ndërmjet Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrin për mandatin e parë ka qenë 1 mijë e 698 vota, pra që ta kemi shifrën pak të koncentruar.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit!

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Sipas llogaritjes të fundit që ne kemi bërë në rezultatin përfundimtar.

**Z. E. Çefa:** Pyetje të tjera nga kolegët nuk ka, jemi të gjithë dakord që t'i japim fund kësaj faze këtu dhe ne tëhiqemi për vendim të ndërmjetëm në lidhje me administrimin e provave dhe për kërkesën e Partisë Demokratike për marrjen e provave të tjera. E ndërpresim seancën për 5 minuta.

*Zbardhi materialin audio*

*Valbona DUSHI*



**Rifillon Mbledhja**

**Ora 15:42**

**Z. E. Çefa:** Rifillojmë seancën duke shpallur vendimin të ndërmjetëm KAS-i i konsultuar në vend vendosi: Administrimin e provave të paraqitura nga dy subjektet ankimues PD-AN dhe Lëvizja Socialiste për Integrin me shumicën e votave KAS vendosi: Të rrëzojë kërkesën e bërë nga Partia Demokratike për administrimin e informacioneve dhe provave shtesë nga institucionet të treta shtetërore me kërkesë të dy anëtarëve të KAS konkretisht anëtarët Çefa dhe Braho do të merren të dhënat e kryqëzuara nga Administrata e KQZ-së të pajisjeve të identifikimit elektronik për zonën zgjedhore Qarku Korçë. Zoti sekretar i përgjithshëm sa kohë mund të na duhet për këtë informacion në mënyrë që t'ua vemë në dispozicion edhe palëve.

**Z.Y.Merkaj:** Besoj sot nga ora 18:00 është gati.

**Z. E. Çefa:** Falemidnerit besoj që këtë seancë mund ta ndërpresim këtu për ta rrimarrë në një moment të dytë, ndoshta nesër apo një ditë tjeter dhe mund të vijojmë me shqyrtimin e kërkesës tjeter ankimore të Qarkut Fier ku relator është kolegu Rusmali.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti kryesues me mirëkuptimin tuaj sepse Qarku Fier ka disa specifika është një qark ku mund të themi që materialet janë voluminoze ne kemi 74 kallëzime penale është një material me shumë prova me

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

shumë fakte. Besoj që jemi në gjendje që të bëjmë konkluzionet përfundimtare për Qarkun e Elbasanit sot dhe të kemi mbase dhe vendimmarrjen edhe për Qarkun e Korçës të bëjmë dhe konkluzionet përfundimtare të kemi një vendimmarrje. Ndërkohë që Qarku i Fierit të shqyrtohet në një ditë më vete kur dhe ne të kemi kohën e nevojshme në dispozicion, sepse besoj se të gjithë edhe për ju por dhe për ne koha ka qenë shumë intensive dhe është një qark që ne kërkojmë të marrë vëmendjen e duhur. Do kërkoja mirëkuptimin tuaj pa imponuar komisionit të mbyllim të gjitha qarqet që kanë mbetur dhe të lemë vetëm Qarkun e Fierit në një ditë të vetme për t'i dhënë të gjithë vëmendjen që meriton. Thashë dhe një herë materialet kanë qenë shumë voluminoze janë të tilla besoj se dhe relatori i çështjes zoti Rusmali e ka konstatuar një gjë të tillë që do të kërkoja me mirëkuptimin tuaj që në një ditë ose nesër, ose të hënën se mbase kanë angazhime të caktuara anëtarët ta shqyrttonim këtë si ankim.

**Z.I.Rusmali:** Partia Demokratike ka përgatitur Qarkun e Fierit që në datë 9 Maj ku ka depozituar kërkesën e vet ankimore bashkë me provat, i ka pasur të gatshme në atë datë në pritje të shqyrtimit. Unë si relator e kam përgatitur të gjithë materialin prej disa ditësh dhe jam në pritje të seancës. Kështu që sa kohë të dyja palët janë të përgatitura për seancën nuk ka asnjë sens që seanca të vonohet, nuk ka kuptim ne jemi gati dhe të përgatitur për gjënë. Unë kam studiuar çdo provë të depozituar, kam nxjerrë pyetjet për çdo provë të depozituar, ata janë sigurisht vetiu të përgatitur se janë përgatitur që para se ta dorëzonin kështu që nuk ka kuptim nuk gjej asnjë motiv të ligjshëm për ta shtyrë shqyrtimin.

*Zbardhi materialin audio*

*Valbona DUSHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 27.05.2021*

**Z. E. Çefa:** Për procedurë avokat në këtë moment nuk jam unë kryesues, tani jemi të gjithë të barabartë sepse seanca ku unë isha kryesues u ndërpren.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Këtë gjë po e kërkojmë po themi në mënyrë besoj me shumë mirëkuptim.

**Z.L.Braho:** Faleminderit zoti Logu ajo që po kuptoj unë zoti Rusmali është shumë e drejtë që thoni ju në lidhje me përgatitjen, por këtu nuk është çështja e përgatitjes së Partisë Demokratike, por besoj që është çështja e zotit Logu se ai ka qenë këtu i pranishëm gjatë gjithë kohës dhe kam përshtypjen ai ka nevojë për përgatitjen në lidhje me këtë çështje meqënëse ai përfaqëson Partinë Demokratike këtu. Patjetër që ato janë të përgatitura se materialet janë, ju e dini se e keni analizuar çështjen dhe kjo është më tepër një mundësi për t'i dhënë zotit Logu kohë për të rifreskuar materialin voluminoz jo për t'i dhënë kohë Partisë Demokratike..

**Z.I.Rusmali:** Që të kuptohemi kjo është çështje që e vendos KAS-i, por KAS-i nuk duhet të vendosë ta marrë në shqyrtim apo jo duhet të vendosë të ndryshojë vendimin e tij për shqyrtimin e seancës sot, se një herë vendimin e keni marrë që sot do të shqyrtohet kjo. Në qoftë se gjeni motive për ta ndryshuar këtë vendim i njobur edhe për palën ankuese, atëherë vendoseni ta ndryshoni vendimin tuaj. Unë jam i përgatitur që të zbatoj vendimin e KAS-it jo ta ndryshoj atë.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



**27.05.2021  
Ora 12:00**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr.40, datë 09.05.2021 të  
subjektit ankues koalicioni Partia Demoktarike – Aleanca për Ndryshim PD –  
AN, për zonën zgjedhore Qarku Elbasan”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvil LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Staf KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, LSI, PS

**Z. E. Lako:** Atëhere çelim seancën për shqyrtimin e ankimit nr. 40 të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 344, dt. 04.05.2021 për miratimin e tabelës përbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore, Qarku Elbasan. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, bëjmë verifikimin e palëve pjesëmarrëse në këtë proces, duke filluar nga subjekti ankues. Është i pranishëm zoti Logu. Në vijim të procesit të mëparshëm, ka ndonjë kërkesë nga ndonjë palë tjetër për të qënë palë e interesuar e procesit?

**Z.Y. Merkaj:** Subjekti zgjedhor Partia Socialiste ka paraqitur kërkesë për t'u përfshirë në këtë procedurë administrative në cilësinë e personit të interesuar, e cila përfaqësohet nga Eridjan Salianji dhe Mariglen Legisi.

**Z. E. Lako:** Po subjekti Lëvizja Socialiste për Integrin?

**Z.Y. Merkaj:** Nuk kemi kërkesë.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. E. Lako:** Meqë e kemi përfaqësuesin e këtij subjekti në sallë. Dëshironi të bëheni pjesë e këtij procesi?

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Po.

**Z. E. Lako:** Atëhere mund t'a depozitonit një kërkesë.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Patjetër .

**Z. E. Lako:** Atëhere KAS i konsultuar në vend vendosi pranimin e këtyre kërkesave dhe vazhdimin më tej të procesit. I bëjmë pyetje anëtarëve të KAS-it dhe palëve nëse kanë ndonjë kërkesë paraprake për procesin? Kërkesë për përjashtim të anëtarëve ka? Për konflikt, për shkak të konfliktit. Atëhere nuk ka. Vazhdojmë me shqyrtimin në themel të çështjes. Shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm mbi objektin e ankimit.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 344, dt. 04.05.2021 ka miratuar tabelën përbledhëse të rezultatit, të zonës zgjedhore Qarku Elbasan për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Kundër këtij vendimi, duke mos qënë dakord, ka paraqitur kërkesë, ankım, subjekti zgjedhor Partia Demokratike, në datën 09.05.2021, me Kërkesën Ankimore nr. 40, e cila kërkon kundërshtimin e vendimit nr. 344 për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, pavlefshmérinë e zgjedhjeve të zhvilluara në dt. 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore në Qarku Elbasan, si dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 për zonën zgjedhore Qarku Elbasan në përiudhë



*Procesverbali i zbardhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

të afërt zgjedhore. Për më tepër përfaktet dhe për arsyetimin ligjor të ankimit besoj do t'a shtjellojë përfaqësuesi i ankimit, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm! Atëhere fillojmë pretendimet, duke filluar nga subjekti ankues zoti Logu.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD -së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës, të nderuar anëtarë të KAS, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim në datën 9 maj 2021 ka paraqitur një kërkesë ankimore kundër vendimit nr. 344 në datën 04 maj 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke kërkuar njëkohësisht pavlefshmérinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Elbasan si dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në gjithë zonën zgjedhore Qarku Elbasan në një përiudhë sa më të afërt. Ne vlerësojmë i nderuar zoti kryesues i seancës që shkeljet ligjore të konstatuara nga ana e Partisë Demokratike janë të mjaftueshme në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor për të konkluduar me pavlefshmérinë dhe përsëritjen zgjedhjeve. Kjo edhe referuar nenit 161 të Kodit Zgjedhor. Në datën 25 Prill 2021 janë zhvilluar zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, ku kanë marrë pjesë 166.048 votues ose 44.96%. Në datën 26 dhe 27 Prill është kryer numërimi i votave për subjektet zgjedhore, gjatë së cilët janë konstatuar 156.162 fletë votimi të vlefshme dhe 9.776 fletë votimi të pavlefshme ose 5.88 %. Mandatet në këtë zonë zgjedhore janë ndarë si vijon, PS 8 mandate dhe PD 6 mandate. Sa i përket fenomenit të blerjes së votës dhe përdorimit të personave me precedentë të tmerrshëm kriminal, Partia Demokratike ka depozituar 11 prova të cilat do i përmendim gjatë analizës sonë. Partia Socialiste në Qarkun e Elbasanit kishte drejtues politik shtetasin Taulant Balla, deputet në detyrë i Kuvendit të Shqipërisë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

Taulant Balla është organizator i një skeme kriminale që përfshin një numër të konsiderueshëm personash me role të ndryshme në këtë grup, të cilët janë të njojur për... qoftë këta të skeduar për rekorde të tmerrshme kriminale, por edhe për përfshirje në shit-blerjet masive të votave. Ashtu siç kemi patur mundësi të relatojmë edhe më herët gjatë periudhës mars-prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar 50 kallëzime penale, ndër të cilat, 30 prej tyre kanë patur të bëjnë me raste flagrante të shitjeve të votës. Në Qarkun e Elbasanit, Partia Demokratike përrastet e shitblerjes së votës, ka depozituar 2 kallëzime, përkatësisht në datën 23 shkurt 2021 dhe datën 07 prill 2021. Në datën 23 shkurt 2021 Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar shtetasin Taulant Balla si dhe çdo person tjetër që bashkëpunonte me të, si dhe me veprimet dhe mosveprmet e tyre, kanë konsumuar veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje. Përdorimi i funksionit publik, i veprimtarisë politike ose zgjedhore. Konkretnisht shtetasi Taulant Balla është denoncuar për shkak se duke përdorur ndihmën ekonomike që u jepet qytetarëve në nevojë, kërkonte mbështetjen e këtyre qytetarëve. Në telefonat e një numri të konsiderueshëm qytetarësh, të cilët janë denoncuar nga ana jonë, kishte mbërritur mesazhi si vijon, "Përshtendetje! Ju flasim nga zyra e Shtabit të Taulant Ballës dhe duam t'ju informojmë se ndihma juaj ekonomike është dyfishuar nga shkurti deri në qershor. Kjo është mundësuar nga Taulant Balla. Presim mbështetjen tuaj, faleminderit". Një rast në vlerësimin tonë flagrant se si taksat e qytetarëve shqiptarë, si paratë e buxhetit të shtetit përdoreshin për t'u kthyer në vota dhe mbështetje për Taulant Ballën dhe Partinë Socialiste. Në datën 7 prill 2021 Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçem Kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar skemën kriminale të blerjes së votës nga persona me rekorde të tmerrshme kriminale në Qarkun e Elbasanit, duke konsumuar në formën e grupit të strukturuar kriminal, veprat penale si pengimi i subjekteve zgjedhore,



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

korruzioni aktiv dhe pasiv ne zgjedhje, marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit dhe shpërdorimi i autoritetit policor. Faktet dhe grupfaktet e evidentuara të blerjes së votës në Qarkun Elbasan nga eksponentë të Partisë Socialiste dhe persona me rekorde kriminale në shërbim të Partisë Socialiste, janë evidentuar, faktuar dhe denoncuar në mënyrë të vazhdueshme nga Partia Demokratike që ne të kemi mundësi t'i shtjellojmë dhe t'i parashtrojmë edhe përpara këtij komisioni. Në Qarkun e Elbasanit nga ana e kandidatëve të Partisë Socialiste, ishte ngritur një strukturë e mirëfilltë kriminale që të cënonte standartet e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të barabarta. Konkretilisht nga informacionet dhe të dhënët që janë mbledhur nga ana jonë është vërejtur se në periudhën përpara zgjedhjeve, kishte një rritje të zgjeruar të aktivitetit kriminal në këtë qark. Ne i kemi denoncuar në mënyrë të vazhdueshme se si shtetas që ishin kallëzuar penalisht nga ana e Partisë Demokratike, në kuadër të një grupimi të mirëstrukturuar, kryenin në mënyrë të përsëritur blerje votash, kërcënimin, intimidimin apo dhunimin e shtetasve që nuk pranonin të mbështesnin Partisë Socialiste. Ne i kemi denoncuar dhe kemi paraqitur fakte publike se si shtetasi Gjergj Luca, pronar i kompleksit “Rozafa” kryente blerje të paligjshme të dokumenteve të identifikimit për një numër të konsiderueshëm të punonjësve të tij, si dhe ishte angazhuar drejtpërdrejt në skemën kriminale të blerjes së votave, duke përdorur një rrjet personash të punësuar prej tij, që kanë bërë shpërndarjen e parave pas hyrjes në fuqi të vendimit të qarkullimit për shkak të pandemisë së COVID-19. Pra, kishte një numër shtetasish të caktuar, të cilët ishin të punësuar, të paguar nga shtetasi Gjergj Luca që vepronin kryesisht pas orës karantinore, kur lëvizjet e qytetarëve ishin të ndaluara. Shtetasi Artan Faik Firaku dhe Xhevahir Njelina gjatë fushatës zgjedhore kanë operuar në lagjen “5 Maji” dhe në këtë lagje kanë mbledhur, të paktën me aq sa ne kemi patur mundësi t'i identifikojmë, mbi 100 karta identiteti, me qëllim që më pas të përdoreshin për manipulimin dhe



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

tjtërsimin e vullnetit të zgjedhëzve. Po ashtu krahas këtyre shtetasve, janë angazhuar edhe shtetasit Endi Haxhia, Mario Çela dhe Gëzim Rusi. Në zonën e Bradasheshit kanë operuar kryesisht shtetasit, Ledi Hoti, i cili bëntë shpërndarjen e parave në këmbim të votës për Partisë Socialiste dhe shtetasi Arben Veseli, i cili po ashtu kryente shpërndarje parash dhe blerje të kartave të identitetit. Në zonën e Bradasheshit ka operuar gjithashtu shtetasi Gentian Mustafa Sharra, lindur dhe banues në Elbasan, person me rekorde të rënda kriminale, i cili vendosi në dispozicion gjithë ambjentet dhe pronat e tij, kryesisht në zonën pranë rrrethrotullimit të Bradasheshit, ku funksiononin një numër i konsiderueshëm personash që i thérresin qytetarët e ndryshëm për të bërë më pas shpërndarjen e parave apo mbledhjen e kartave të identitetit, kryesisht kjo për banorët e zonës së Bradasheshit dhe Fushë Mbretit. Krahas këtyre shtetasve, pra shtetasve Arben Veseli dhe Gentian Mustafa Sharra, kanë vepruar edhe shtetas të tjerë të skeduar në fakt për veprmtari kriminale dhe rekorde të tmerrshme kriminale si Marsel Rroka apo Klment Xhaferri. Në zonën “11 Nëntori” dhe në zonën “Harqet – Firakasit” shtetasi Arjan Sinani me detyrë ish-polic bashkiak në Bashkinë Elbasan, ka ofruar në këmbim të votës për Partisë Socialiste shuma prej 5.000 lekësh të reja. Po ashtu në zonën “11 Nëntori” janë angazhuar në mbledhjen e dokumenteve të identifikimit të blerjes së votave edhe shtetasit Tip Muzhaqi, Gent Derzeza apo dhe shtetasi Aurel Kaja. Po ashtu në lagjen “Emin Matraxhiu” ka vepruar shtetasja Dhurata Shyqyri Mata, e cila mban detyrën e Shefes të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Hekurudhë, në pozicionin e Kryetares së Forumit të Gruas Socialiste. Kjo shtetase ka mbledhur kartat e identitetit të qytetarëve përkundrejt shumave që shkonin nga 50.000 deri në 70.000 lekë të vjetra. Disa prej shtetasve, të cilëve u është marrë karta e identitetit e të cilët kanë denoncuar marrjen e kartës së idenitetit apo janë bërë fakte publike janë shtetasit, Luljeta Kotorri, Zenepe Mustafa Tomorrica, Flamur Bullaj, Veli Buzani, Afërdita




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

Buzani etj. Të gjithë këta të denoncuar dhe kallëzuar nga ana e strukturave të Partisë Demokratike. Në Lagjen “Dyli Haxhire” me blerjen e votave dhe mbledhjen e dokumentave të identifikimit është angazhuar Arian Ibershimi, ndërsa në lagjet “Ruga e Re e Trenit” dhe “Haxhias” ishin aktivizuar në blerje votash dhe mbledhje kartash identiteti shtetasit, Met Peqini, i ashtuquajturi “Meti i Tujës”, Tip Caka, Shaqir Prroi, Donald Varfi dhe Shyqeri Hoxha. Po ashtu një numër i konsiderueshëm shtetasish, të cilët janë cituar nga ana jonë në faqet 7 dhe 8 të kërkesës ankimore, përkatësisht shtetasit Gen Coku, Ervin Gjoka, Durim Koci, Ligor Macolli, Durim Sadiku, Art Majori, Gjen Ndreca, Shkëlqim Deliu, Kujtim Haka, Ibrahim Musmuça, Altin Fizaku, Shazivar Haka. Ishin të gjithë këta të angazhuar në skemat e shpërndarjes së parave dhe mbledhjes së kartave të identitetit, në disa zona të ndryshme të Qarkut të Elbasanit. Të gjitha sa më sipër janë të provuara dhe faktuara se gjithçka që ne kemi pasur në dispozicion dhe sigurisht edhe me faktin që ne kemi parashtruar dhe relatuar në kallëzimet penale të depozituara në Prokurorinë e Posacme kundër Korruptionit dhe Krimtit të Organizuar në dt. 23.02.2021 dhe 07.04.2021. Sigurisht PD – AN nuk mund të kryente përvetësimin e funksioneve të Policisë së Shtetit, të Prokurorisë apo të Gjykatës, por këto fakte i ka relatuar, i ka parashtruar në Prokurorinë e Posacme kundër Korruptionit dhe Krimtit të Organizuar dhe me të drejtë ka pritur që këto institucione të vepronin. Prandaj, sigurisht që ky nuk është moment procedural, por kjo është arsyja pse ne kemi kërkuar në mënyrë të përsëritur që pranë Prokurorisë së Posacme kundër Korruptionit dhe Krimtit të Organizuar dhe pranë prokurorive të rretheve, të merren informacione zyrtare, në cilësinë e provës, të cilat do të sillnin rezultatet konkrete të atyre që ne kemi patur mundësi të denoncojmë. Është fakt i njohur publikisht, se unë besoj se anëtarët e këtij komisioni janë njohur me raportin paraprak të misionit të vëzhguesve të OSBE / ODIHR se shit-blerja e votës ishte një problem që vazhdoi të mbetet shqetësim



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

për qytetarët. Pavarësisht se vëshguesit e OSBE / ODIHR patën numër të kufizuar në fakt të vëzhguesve, siç e pranojnë në raportin e tyre, gjithsesi kishte raste flagrante kur u konstatua edhe nga ana e tyre raste të shitblerjes së votës. Por ashtu siç kemi patur mundësi të relatojmë dhe shpjegojmë edhe në ankime të tjera që janë bërë nga ana jonë, blerja e votës nuk u krye thjesht dhe vetëm nëpërmjet dhënies të së hollave apo nëpërmjet dhënies së parave, për të cilën pati një bashkëpunim të ngushtë midis drejtuesve të Partisë Socialiste me individë me rekorde kriminale. Të gjitha këto të provuara dhe faktuara me provat që Partia Demokratike ka pasur në dispozicion dhe ia ka vënë në dizpozicion qoftë këtij komisioni, qoftë Prokurorisë së Posaqme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar apo prokurorive të rretheve. Nga ana tjetër siç pata mundësi të parashtroj edhe më herët, Partia Demokratike ka denoncuar në fakt edhe në prokurori skemat se si ndihma ekonomike u përdor masivisht në Qarkun e Elbasanit nga shtetasi Taulant Balla, drejtues politik i Partisë Socialiste dhe Sekretar i Përgjithshëm i kësaj partie, për të manipular apo tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve. Shtetas të ndryshëm janë marrë me numra telefoni apo ju është dërguar mesazh me numra, që ne i kemi identifikuar se cilët janë këta numra dhe lehtësisht mund të provohet se cilët janë shtetasit pas këtyre numrave.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nëqoftëse do të kryhej një hetim i plotë dhe i gjithanshëm të cilët merreshin në telefon dhe ju thuhej që dyfishimi i ndihmës së tyre ekonomike është bërë falë Taulant Ballës. Prandaj në zgjedhjet e 25 prillit, ne presim që ky dyfishim të përkthehet mbrapsht në mbështetje për Taulant Ballën dhe kandidatët e tjerë të PS-së. Kemi pasur mundësi të shpjegojmë gjerësisht e mbështetje sështë nevoja të ndalemi sërisht se si pati një vendimmarrje qoftë të organeve qendrore apo dhe vendore që prodhuan përfitime për kategori të caktuara shoqërore. E gjitha kjo në kundërshtim me nenin 91, pika 4, të miratuar po nga KQZ, i cili synonte të ndalonte nxjerrjen e çdo akti nënligjorë apo ligjor që sillte përfitime për kategori të caktuara shoqërore se nuk ka pikën e dyshimit që nqs organet qendrore dhe ligjore lehojen që të nxjerrin akte duke sjellë përfitime dhe të mira për kategori të caktuara shoqërore këta qytetarë nuk do të jenë më në ushtrimin e lirisë së tyre por do të gjenden nën manipulimin nga ana e pushtetit, qoftë ky pushtet qendor apo lokal. Nga ana tjetër nuk ka pikën e dyshimit që nqs një parti përdor çdo lloj burimi shtetëror, çdo lloj aseti, çdo lloj leje, license apo çdo lloj gjëjë që ka në dorë nuk mund të flasim për garë të barabartë ndërmjet subjekteve zgjedhore por do të kemi rezultat të parashikuar shumë kohë përparrat ditës së zgjedhjeve. Kjo është arsyja që PD nuk mendon që të gjitha këto shkelje ligjore, blerja e votës, përdorimi i aseteve publike, vjedhja dhe përdorimi i paligjshëm i të dhënavë personale, ndalimi i të drejtës së emigrantëve, fletët e votimit të pavlefshme apo votimi më shumë se sa një herë do të gjenden në kutitë e votimit sepse janë shkelje kohë përparrat se qytetarët ti drejtohen kutive në ditët e votimit. Megjithatë detyra jonë, që ne do të vazhdojmë ti relatojmë dhe parashtrojmë këto shkelje qark pas qarku, ashtu siç ato kanë ndodhur duke shpresuar deri në fund që do këtë një reflektim për tu kthyer në binarët e ligjshmërisë. Shteti në fakt nuk veprojë në mënyrë të pavarur por vendos tërësisht

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



***Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve***  
**Dt.27.05.2021**

në shërbim të PS-së. Tërësisht në shërbim të kandidatëve të saj në mënyrë që të maksimizoheshin zgjedhjet. Është fakt publik që shteti dhe PS në këto zgjedhje funksionuan si një parti shtet, skema që nuk ishin parë që prej vitit 1991 kur shteti Shqiptarë hoqi dorë njëherë e përgjithmonë nga partia shtet. Kryeministri Rama, ministrat, deputetët dhe kryebashkiakët e PS-së përdorën investimet publike për propagandë politike, në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja. Ne kemi pasur mundësi që të evidentojmë, faktojmë dhe provojmë përpara këtij komisioni dhe organeve të tjera të paktën 20 raste në të cilat ishin përfshirë deputetë të PS-së, kandidatë apo kryetar bashkive duke i vendosur investimet publike në qëllim të fushatës elektorale. Raste që PD ka pasur mundësi të evidentojë dhe faktojë si ato ku shfaqet drejtuesi i PS-së, Taulant Balla, Kryetari i Bashkisë Elbasan apo siç është rasti i zotit Besian Ajazi, Kryetari i Bashkisë së Cërrikut, Kryetari i Bashkisë Gramsh etj. Të gjitha këto në fakt provojnë qartazi se investimet publike që po kryeshin në atë periudhë në Qarkun e Elbasanit apo që nuk ishin planifikuar për tu kryer por që nevoja e PS-së për të mbledhur vota ja u diktonte e po perdorej gjithçka me qëllime të pastra elektorale çka është një fakti i evidentuar edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR e konkretisht edhe në deklaratën që bëri shefja e misionit të OSBE/ODIHR, e cila në mënyrë të perifrazuar tha që shteti dhe partia pothuajse u shkrin në një të vetme. Kemi pasur mundësi ta themi dhe s'ka si të bëjë përjashtim rasti i Elbasanit, ku e gjithë administrata shtetërore u vendosën në dispozicion të PS-së. Drejtoritë vendore arsimore, drejtoritë vendore të bujqësisë, spitalet rajonale, shkollat e mesme, agjencitë vendore të kadastrës, administratat e policisë dhe burgjeve, gjendja civile etj, u kthyen gjatë fushatës zgjedhore në shtabe elektorale të PS-së. Të gjithë ne që jemi këtu kemi pasur mundësinë të dëshmojmë që të paktën në dy qarqe atë të Beratit dhe Durrësit, PS solli si vëzhgues të saj

***Zbardhi materialin audio***  
***Silvi SINO***



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

punonjës të administratës publike, të cilët janë denoncuar nga ana jonë që provon dhe një herë se si e gjithë administratë shtetërore u vendos në funksion të fushatës së kësaj partie. Po ashtu ne kemi pasur mundesi të denoncojmë në mënyrë të përsëritur faktet e bëra publike se si mbështetësit dhe kandidatët e PS- së në Qarkun e Elbasanit u intimiduan, u kërcënuan dhe dënuan dhe sigurisht që janë fakte që ne j'ua kemi vënë në dispocizion në faqen 12-13 të kërkesës tonë ankimore. Ne kemi relatuar në mënyrë të përsëritur fakte publike dukë pasur parasysh rritjen e numrit të punonjësve në administratën publike, plot 13mijë në vetëm 4 muaj dhe ka një parashikim të qartë në nenin 91 pika 3 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor që ndalon punësimin 4 muaj përpara zgjedhjeve përvçese kur e diktojnë nevojat e ngutshme. Deri më tani as në Qarkun e Elbasanit e as ndonjë qark tjetër e as në Bashki të Elbasanit e as nënbashkitë e ndonjë qarku nuk kemi parë se cilat ishin nevojat e ngutshme të vendeve të punës në administratën publike, qofshin këto me kontratë të përkohëshme apo të përhershme. Sigurisht informacioni që disponon partia PD-AN është i kufizuar sepse është e hera pare, të paktën 30 vitet e fundit këtu ka njerëz që janë marrë me zgjedhje dhe këtë mund ta dëshmojmë lehtë që opozita ka hyrë në zgjedhje pa pasur asnjë lloj pushteti dhe sigurisht mungesa e çdo lloj funksioni publik e bëri më shumë vulnerabël për të pasur më shumë informacion se çfarë po ndodhte në institucionë. Kjo është arsyja që nga ana jonë në mënyrë të përsëritur, përvec 100 kërkesave që ne kemi dërguar për informacion dhe që do i depozitojmë edhe në këtë proces në cilësinë e provës kemi kërkuar nga ana e këtij komisioni që bënte zbradhjen e plotë, transparencë të plotë, se si u soll administratë publike, në 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, se si u përdorën lejet e legalizimit, se si u përdorën lejet e ndërtimit, tenderat dhe koncesionet publike dhe jemi të sigurt që nqs këto prova do të merreshin dhe administroheshin do zbardhej e plotë ajo ç'ka e kemi konsideruar masakrën e 25

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

prillit. Do vazhdojmë t'i kërkojmë këtij komisioni duke përkthyer në binarët e ligjshmërisë duke marr informacion pranë agjensisë shtetërore të kadastrës që ka në bindjen tonë të plotë edhe rezultoj që ka një numër jashtëzakonisht të lartë të lejeve të legalizimit të shpérndara në këmbim të votës. Shumë herë kemi pasur mundësinë të relatojmë dhe më herët dhe do vazhdojmë ta përsërisim dhe duhet të rezultojë në pavlefshmërinë e zgjedhjeve fakti se të dhënat personale të qytetarëve u vodhën dhe u përdrën për qëllime elektorale të PS-së duke bërë publike të dhënat personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike u morrën e u përdoren diku në disa zona të errëta që askush nuk e di cili ishte qëllimi. Qoftë kjo si përfaqësues i PD-AN qoftë kjo si qytetar për mua është alarmante që të dhënat e mijë personale, që unë ja kam besuar shtetit shqiptarë, të përdoren nga patronazhistë qoftë kjo të PS-së apo kushdo qoftë kjo parti politike. Ne kemi pasur mundësi pasi jemi të bindur që kjo ka ndikuar dhe në Qarkun e Elbasanit sesi një vendim vetëm një javë përpara datës së zgjedhjeve ju mohoj në mënyrë kategorike të drejtën për të votuar 500 mijë zgjedhësve Shqiptarë. Rasti i Gjirokastrës na ka dëshmuar në fakt së ndalimi nuk u bë për të gjithë votuesit por kishtë target kryesor votuesit e opozitës të cilët jemi të bindur nqs nuk do kishte ekzituar ky vendim do ndikonte dukshëm në rezultatin e zgjedhjeve dhe kemi pasur mundësi ta shpjegojmë gjerësisht që sigurisht 500 mijë zgjedhës me të drejtë votë që sipas praktikave që ka mbajtur KQZ më herët duhet ti konsiderojmë këta shqiptarë që mund të vinin potencialisht për të votuar në zgjedhjet e 25 prillit. Po ashtu kemi relatuar dhe shpejguar përpara këtij komisioni fakt publik i konstatuar dhe nga raporti paraprak i OSBE/ ODIHR që zgjedhësit e infektuar me Covid 19 ju mohua e drejta për të votuar në zgjedhjet e 25 prillit. Kemi relatuar dhe shpejguar gjerësizht që një fletë votimi e cila të vlerësimin tonë ishte në kundërshim më kriteret e vendosura nga Kodi Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 te Kodit të praktikës së

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

mirë në çështjet zgjedhore solli si rezultat pa vlefshmérinë e vullnet të 83 mijë qytetarëve në rang republike. Ndërsa pavlefshmérine e vullnet të 9776 zgjedhësve në Qarkun e Elbasanit ose 5.88%. Ndërkokë që diferenca në fakt për mandatin e zgjedhësve ishte rreth 7266 vota më pak se numri i fletëve të votimit të pavlefshëm. Kemi relatuar përpala këtij komisioni dhe kjo do provohet edhenga prova që duhej të merrej nga ana e këtij komisioni se edhe në Qarkun e Elbasanit pati raste të votimit të hsumëfishtë të votimit familjar apo votimit për të tretët. Sigurishtqë përdorimii teknologhidë i kërkuar me insistim nga PD në këto zgjedhje na jep mundësi të kuptojmë sa janë përmasat reale të këtij fenomeni. Për aq sa na intereson ne, kjo bëhet e mundur nëpërmjet marrjes së të dhënave që vijnë nga pajisjet PEI. Sigursiht hetime të mëtejshme që duhet të kryhen nga organe lig zbatuese do të zbardhin të plotë se çfarë ka ndodhur në Qarkun e Elbasanit në zgjedhjet e 25 prillit prandaj sigurisht edhe në këtë kërkesë ankimore do te qendrojë e pa ndryshuar kërkesa e PD dhe PD-AN që të administrohen këto prova sepse jemi të bindur që do të zbardhim deri në fund të vërtetën dhe fatmirësisht kjo nuk kërkon të ketë shumicë por të jetë në vullnetin e dy anëtarëve. Për të konkluduar të nderuar anëtarë të komisionit, duke ju falenderuar për vëmendjën, për të mos më ndërprerë deri në fund, për ne zgjedhjet e 25 prillit në Qarkun e Elbasanit u diktuan qartësisht nga krimi dhe paligjshmëria nga një fenomen i përhapur në çdo lagje çdo zonë, çdo njëri administrative të qarkut Elbasanit ku drejtues politikë të PS-së me të shkruar të dyshimtë, se si ata kanë ardhur në politikë, përdorën elementet e krimit të organizuar, persona me rekorde të rënda kriminale për të sjellë vota dhe pastaj për të prodhuar mandate në favor të PS-së. E po ashtu përdorimi i çdo aseti publik, përdorimi i çdo lloj fondi, i lejeve, licencave, i shtetit duke vepruar si parti shtet e deformojë dhe tjetërsojë vullnetin e zgjedhësve Shqiptarë ashtu si dhe faktet e tjera që pata mundësi ti relatoj. Prandaj

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

në përfundim, sigurisht do kemë mundës, që me këtë të merremi dhe në fazën e konkluzioneve përfundimtare. Ne shpresojme shumë megjithëse deri tani është e shkruar ndryshe, që ky komision do kthehet në binarët e ligjshmërisë, duke pranuar kërkesën tonë për pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, nga përfaqësuesit e palëve të interesuara ka diçka për të thënë?

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Ne vlerësuam që kërkesa duhet të rrëzohet si e pa bazuar në ligj dhe prova. Nga përbajtja e ankimit në pikën 2 të saj ne konstatojmë që kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore, Qarku Elbasan ndërkokë që Kodi Zgjedhor e ka përcaktuar ndryshe dhe legjitim që pavlefshmëria e zgjedhjeve kërkohet vetëm në qendrën e votimit. Po ashtu dhe në Vendimin numër 3, të Komisionit Rregulator, datë 6.11.2020, është përcaktuar dhe në nenin 9, e drejta e ankimit si dhe nenin 10, që në kërkesën për pavlefshmëri përcaktohen qendrat e votimit në të cilat kërkohet ndryshimi i rezultateve dhe në përbajtje të ankimit, nuk rezulton që ka një mospërputhje ndërrmjet asaj ç'ka kërkohet dhe asaj ç'ka arsyetohet, pra nuk është se pala ankuese ka kërkuar pavlefshmëri të zonës zgjedhore, më pas ka kërkuar pavlefshmëri për secilën qendër votimi. U përmendën një tërsi vakteh dhe ngjarjesh që nuk u arsyetua në asnjë moment, lidhja shkak pasojë prej pales në këtë kuptim. Ne vlerësojmë, se kërkesa duhet të rëzohet në bazë të nenit 160, të Kodit zgjedhor, nenin 9, pika 4 dhe nenin 10 të vendimit nr.3 të Komisionit Rregulator, ku kërkesa është e pa argumentuar dhe pa bazuar në ligj zoti kryetar, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. E. Lako:** Faleminderit, po përfaqësuesi i LSI.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit, thjeshtë në mbështetje të kërkesës bërë nga PD dhe ne kërkojmë që të merret në konsideratë si kërkesë bazuar në objketin që ka.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje nga ç'ka dëgjuam lidhur me pretendimet? Po zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Për zotin Logu, kisha një pyetje. Siç e tha ai dhe do kisha interes të dija, cila është përmbajtja e Vendimi nr.85 datë 10.02.2021 i Këshillit të Ministrave?

**Z. E. Lako:** Me mikrofon ju lutem.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Vendimi që ne kemi cituar është në faqen 10 të kërkesës tonë ankimore dhe faqen 9.

**Z. I. Rusmali:** Nuk është e rëndësishme, se unë përmbajtjen e gjej, por ka rëndësi në kontekstin e asaj që parashtroni.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.85 datë 10.02.2021 është një vendimi cili lejon që për periudha të caktuara kohore të procedohet me dy fishim e përkohëshëm të ndihmës ekonomike dhe konteksti në të cilin ne e kemi sjellë këtë vendim, i cili është i depozituar dhe ju zoti Rusmali mund të njiheni gjérësisht me të, është fakti që pikërisht ky vendim është përdorur

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

nga drejtuesi politik i Qarkut Elbasan për të dy fishuar ndihmën ekonomike për familje të caktuara.

**Z. I. Rusmali:** Në çfarë rrrethana dyfishohet ndihma ekonomike, mund të na e sqaroni?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për të bërë një relatim të plotë zoti Rusmali, unë doja që të gjeja dhe vendimin dhe t'ju citoj kriteret që duhen për të dy fishuar ndihmën ekonomike për qëllime të këtij hetimi administrativ që ne jemi duke kryer në këtë sallë ka rëndësi fakti i cili ai është një vendim dhe është përdorur si mekanizëm për të dy fishuar ndihmën ekonomike për zgjedhës të PS-së të cilët më pas duhet t'i ofronin mbështetje kandidatit të kësaj partie, drejtuesit të përgjithshëm, Taulant Balla. Ky është një vendimi cili në tërësinë e provave që ne kemi depozituar pranë këtij komisioni është depozituar por sigurisht nqs kërkohet njohje e thelluar, po marrin pak kohë për ta shqyrtuar.

**Z. I. Rusmali:** S'ka problem, por më bëri përshtypje fakti që ju thoni "duke shfrytëzuar këtë vendim". Këtë vendim, siç e kuptojë unë, ju nuk e atakoni, nuk e quani të kundraligjshëm, nuk e quani në kundërshtim me Kodin dhe prandaj më bëri përshtypje. Pjetja që kam dyfishimi i ndihmës ekonomike në vetëvete, i pa lidhur me çështjen, është veprim që mund të konsiderohet i ligjshmëm apo është gjithësesi i pa ligjshëm?

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Rusmali, vendimi në fjalë për të cilin po flasim titulli i tij është “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës për përfitimin e ndihmës ekonomike de përdorimt të fondit shtesë mbi fondin e dorëzuar për ndihmën ekonomike”, është një vendim i cili në kushtet kur plotësohen disa kushte të caktuara, të clat i përmban vendimi dhe thashë që në qoftë se i intereson këtij debati mund ta bëjmë. Nuk besoj se është këtu me interes. Sigurisht që po themi që në kontekstin normal kur nuk përdoret për qëllime politike, ai është një vendimmarrje që bazohet në akte ligjore të prodhuara nga Parlamenti Shqiptar. Pra, në vetvehte ne nuk kemi kundërshtuar vendimin, i cili sigurisht që duke u shfrytëzuar në mënyrë të ligjshme mund t'u vijë në ndihmë familjeve që janë në nevojë. Por për sa kohë që ky vendim përdoret që më pas t'u serviret familjeve në nevojë që ky dyfishim i ndihmës tuaj ekonomike u bë falë mbështetjes së kandidatit të Partisë Socialiste Taulant Balla. Kjo në vlerësimin tonë përbën shkelje të Kodit Zgjedhor të cilat duhen vlerësuar si të tilla nga ana e këtij komisioni. Ne nuk e kemi thënë për asnjë moment, e faleminderit që më jepni mundësinë të vazhdoj, që ne nuk jemi kundër dhënies së ndihmave për familjet në nevojë, as familjeve që preken nga tërmeti, as familjeve të varfëra. Kur kjo ndihmë përdoret për qëllime të pastra politike, sigurisht që ne vlerësojmë që është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, edhe në kundërshtim me Kodin Penal, që ne nuk kemi pas mundësinë të bëjmë kallëzimet përkatëse.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kjo do të thotë që për ne nuk ka nevojë, sipas asaj që thoni ju, që ne të përqëndrohem i vendimi nr. 85 i Këshillit të Ministrave të këtij viti.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ka nevojë të përqëndrohem i tek përdorimi i tij.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Në qoftë se nuk e lejon pyetjen, nuk ke mundësi të japësh përgjigjen! Tek ky komponent, ne nuk kemi nevojë të përqëndrohem, sepse ju e vlerësoni si të rregullt dhe të ligjshëm këtë vendim dhe përdorimit normal të tij. Tani kemi një problem me mënyrën se si ky është përdorur në Elbasan sipas pretendimeve tuaja. Ju sa raste keni identifikuar të kësaj ngjarjeje që ju i referoheni si shkelje?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne i nderuar për gjithshka që kemi thënë dhe që kemi pas mundësinë të parashtrojmë para këtij komisioni, kemi vendosur ato prova që ne kemi pas në dispozicion. Ne kemi identifikuar një sërë numrash telefonash, të cilat janë në faqen 10. Pra, numrat e telefonit që ne kemi këtu janë rrëth pesë numra telefoni dhe për më tepër për të kryer hetime dhe verifikime të plota, ky ka qenë një rast që PD-AN e ka referuar dhe e ka kallzuar në prokurori. Për t'i shkuar zbardhjes le të themi deri në fund jemi në kuadër të ndjekim të njejtin diskutim që kemi bërë vazhdimisht me ju dhe me përfaqësuesit e tjerë që kjo do të kërkonte marrjen e informacionit zyrtar nga prokuroria në cilësinë e provës për të kuptuar se sa janë përmasat reale të këtij fenomeni. Sigurisht që denoncimet tonë e kuptoj që ka njerëz në masë..

**Z. I. Rusmali:** Po e riformuloj pyetjen. Sa raste keni referuar në prokurori të qytetarëve që u është dërguar ky mesazh nga ato pesë numra telefonë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne i kemi referuar i nderuar të paktën pesë mesazhe që i janë dërguar nga këta numra dhe kemi kërkuar që më pas këto raste të identifikohen deri në fund, sepse jemi të bindur se dhe qytetarë të tjerë nga këta numra kanë marrë telefonata dhe mesazhe e kështu me rradhë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Merita Dulaku*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Pra, ju keni pesë raste që i konfirmoni dhe me telefonin dërgues dhe me telefonin mbërritës të mesazhit dhe e imagjinoj dhe me përmbajtjen e mesazhit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Kjo është përmbajtja e kallzimit tonë penal të datës 23 shkurt 2021 të cilën sigurisht ua kemi vënë në dispozicion në cilësinë e provës.

**Z. I. Rusmali:** Pesë raste, dakord!


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Mjaftueshëm për të bërë bazë për kallzimin tonë penal.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, janë të mjaftueshme, dakord. Unë dua të di sa janë rastet, sepse rastet kanë vlerë për ne. Është mirë të thuhet që në fillim që kemi identifikuar pesë raste. Tek pika 19 juaja, flisni për 11 raste kur Taulant Balla ka pëdorur investimet publike për qëllime të fushatës zgjedhore. Mund të na e shpjeoni në ç'sens i ka përdorur investimet publike?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Tani, i Nderuar, mendoj që për ato raste, se e di që do të bëjmë përsëritje të vetes, por për të gjitha rastet që ne kemi pas mundësinë të denoncojmë, ose të tregojmë përpara jush. Ne kemi paraqitur para këtij komisioni edhe materiale, foto dhe video, se si në periudhën zgjedhore, ose në periudhën 4-mujore para zgjedhjeve përgjatë kësaj periudhe investimet publike të cilat kanë të bëjnë me rrugë, rindërtimë shtëpiash. Kanë të bëjnë me investime të tjera publike si qendra arsimore, shëndetësore e kështu me rradhë, janë promovuar gjatë kësaj periudhe. Ato mund të kenë qenë investime të cilat e kanë nisur procedurën dhe më

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

parë, ose mund të kenë qenë investime për të cilat procedura ka filluar gjatë fushatës zgjedhore. Ashtu siç ne e kuptojmë ligjin, ashtu siç ne kuptojmë vendimin nr.9/2020 të Komisionit Rregulator përdorimi apo promovimi i investimeve publike gjatë periudhës 4 muaj para zgjedhjeve është në kundërshtim me këtë vendim. Kjo krijon dukshëm një favorizim të pabarabartë ndaj një subjekti zgjedhor në raport me një subjekt tjetër. Nuk besoj se Partia Demokratike ka pasur mundësinë të promovoje investime publike.

**Z. I. Rusmali:** Ju përmendët, futët në lojë vendimin nr. 9 të dhjetorit të 2020 të Rregulatorit. Rregulatori ka vodosur një specifikë për ndalimin e veprimtarive publike me investimet. Një specifikë që ka lidhje me momentin e financimit të këtyre investimeve publike. Në analizën tuaj të 11 rasteve, sa hyjnë këto tek kjo specifikë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Rastet që ne kemi pas, rastet për të cilat ne kemi paraqitur provat tona, kanë të bëjnë me investime që janë kryer posaçërisht në periudhën që është e ndaluar nga vendimi i Komisionit Rregulator.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, dmth në vlerësimin tuaj janë investime të çelura lirishtazi në periudhën 4-mujore dhe që i inagurohen si investime të çelura rishtas?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Të promovuara vetëm nga Partia Socialiste, drejtuesit e saj e kështu me rradhë.

**Z. I. Rusmali:** Secili promovon të vetat. Po janë investime të çelura rishtas.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nga verifikimet që kemi bërë, i Nderuar, po! Për më tepër, ne kemi paraqitur dhe provat përkatëse të cilat sigurish presupozojmë që ju i njihni.

**Z. I. Rusmalı:** Do t'i vlerësojmë! Dakord, faleminderit!


**Z. E. Lako:** Faleminderit, ka ndonjë pyetje tjetër nga anëtarët e KAS-it? Jo! nga palët ka ndonjë prapësim? Jo! atëherë, mendoj se mund të vazhdojmë me prapësimin e provave të paraqitura nga pala ankuese dhe kërkesat eventuale që mund të kenë palët për kërkesa të reja. Duke filluar nga ju zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës. Për sa i përket provave që ne i kërkojmë të administohen në këë poces që besojmë se fakojnë dhe provjnëplotësisht të gjitha pretendimet tonë, por që sigurisht kanë nevojë të mbështeten dhe nga prova të tjera të ciat besoj në një moment të dytë procedural do t'i ezaurojmë. Janë të cituara në faqen 55 dhe 56. Janë në numër 36 prova, kanë të bëjnë kryesisht me materiale shkresore të cilat janë marrë nga burime të ndryshme, kryesisht burime publike. Sigurisht dhe materiali që ne cituam përgjatë relatimit tonë. Në qoftë se ju e vlerësoni të nevojshëm mund edhe t'i citojmë provë pas prove. Në qoftë se ju e vlerëson, qoftë dhe për ekonomi kohe të mos i citojmë, por mjafton që janë të cituara në faqen 55 dhe 56.

**Z. E. Lako:** Dakord! Në lidhje me kërkesën për prova të tjera?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për sa i takon povave që ne kërkojmë i Nderuar, nisur dhe nga diskutimi që patëm me anëtarin e KAS-it, ne mendojmë që ne kemi

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

pas mundësi të kufizuara për të sigruar çdo provë që do të saktësonte në mënyrë të saktë se sa kanë qenë përmasat reale të shkeljeve të ndryshme të ligjit që ne kemi ngritur dhe paraqitur para këtij komisioni, kjo është arsyja që në faqen 49, 50 dhe 51 të kërkesës tonë ankimore, kemi kërkuar që të merren një sërë informacionesh zyrtate nga ana zyrtare e administratës publike të cilat në vlerësimin tonë, do të provonin pretendimin që ne kemi ngritur para këtij komisioni. Kjo kërkesë është në vlerësimin tonë, plotësisht në përputhje me nenin 137, pika 1 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon të drejtën e palëve për t'i kërkuar KAS-it që të marrë në cilësinë e provës informacione, dokumente, apo sende të tjera që quhen të nevojshme për të vërtetuar pretendimet e saj. Në qoftë se është e nevojshme dhe ky komision e vlerëson si të tillë, unë mund të citoj se cilën prej kërkesave që ne kemi bër, të 19 kërkesave siç janë bërë, përfshirë këtu dhe një provë që mund të merret nga ana e KAS-it sepse ndodhet në dispozicion të administratës zgjedhore dhe ka të bëjë me të dhënat e kryqëzuara të pajisjes PEI, siç kemi vepruar dhe në raste t ë tjera. Ndërkohë që provat e tjera janë prova që në vlerësimin tonë do të zbardhin masakrën zgjedhore të ndodhur në Qarkun e Elbasanit në qoftë se administrohen nga organet e administratës publike. Nqs e vlerësoni të nevojshme e citoj, nqs e vlerësoni se janë mjaftueshëm të cituara, besoj se nuk është e nevojshme.

**Z. E. Lako:** Po zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Zoti Logu, kam një pyetje. Është e disata herë në një sërë çështjesh që janë në shqyrtim këtu, ju sillni një numër të konsiderueshëm kërkesash që janë tek 100 kërkesa që subjekti zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë ia ka nisur institucioneve shtetërore. Nga sa kam vënë re unë nga këkesat, këto kanë të paktën

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.27.05.2021*


që me datën 18 Maj që i janë drejtuar këtyre institucioneve shtetërore. Ka pas ndonjë eagim nga këto institucione shtetërore lidhr me kërkesën që ju i keni drejtuar?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit shumë për pyetjen zoti Braho! Nuk ka pas asnjë dokument, asnjë inormacin të vënë në dispozicion nga institucionet publike të cilave u jemi drejtuar. Të jeni i bindur se në qoftë se ne i marrim këto informacione nëpërmjet kërkesave që kemi kërkuar, ne do t'i heqim ato kërkesa për të cilat kemi marrë përgjigje dhe do t'i paraqesim para këtij komisioni në cilësinë e provës. Deri tani që po flasim ua konfirmoj që PD-AN ka marrë zero përgjigje për 100 kërkesa për informacion që i ka drejtuar organeve të administratës publike.

**Z. L. Braho:** Përveç kësaj po ndonjë qasje publike të këtyre institucioneve në lidhje me gjithë këto kërkesa që janë bërë nga ana e Partisë Demokratike, ka pas ndonjë institucion që ka reaguar në mënyrë publike jo në në mënyrë shkresore?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Deri më tani ne nuk kemi parë deklarata publike që të jenë publikuar në media apo në faqet e tyre zyrtare. Sigurisht që organet edhe në përputhje me të drejtën e informimit, ligji 119/2014, kanë detyrën që të bëjnë maksimalisht transparencë dhe ne çdo informacion që ka qenë i publikuar në faqen zyrtare të këtyre institucioneve nuk është se e kemi kërkuar sërisht, apo ia kemi kërkuar komisionit që ta marrë, por e kemi marrë vetë dhe e kemi sjellë në cilësinë e provës përpëra këtij komisioni. Pra, deri më tani nuk kemi parë asnjë lloj reagimi të këtyre institucioneve, lidhur me kërkesat tona për informacion të cilat të jeni të bindur ju dhe kushdo tjetër që në momentin që ne i marrim, nuk do t'i kërkojmë këtij komisioni që të bëjë punë të dyfishtë sepse do të ishte e panevojshme.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni i Ankimoreve dhe Sanksioneve*

*Dt.27.05.2021*


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Lidhur me kërkesat tona për informacion, të cilat të jeni të bindur ju dhe kushdo tjetër që në momentin që ne i marrim nuk do i kërkojmë këtij komisioni që të bëjë punë të dyfishtë, sepse do të ishte e panevojshme.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu që na konfirmuat heshtjen e të gjithë këtyre institucioneve, nuk kam pyetje tjetër.

**Z. E. Lako:** Për të bërë një sqarim në lidhje me këto shkresa ne i kemi administruar se janë të njëjta dhe në rastet e tjera dhe këto nuk janë prova në kuptimin e provës. Këto janë disa shkresa që i janë drejtuar insitucionit shtetërore në bazë të ligjit për të drejtën e informimit dhe pas verifikimit që i kemi bërë, ato rezultojnë që këto institucione janë njojur me këto shkresa në datën 18 dhe nuk dua të bëj avokatin e institucioneve po ka ca afate ligji për të drejtën e informimit kur kthehet përgjigjia dhe si kthehet përgjigjia, besoj as të flasim në emër të institucioneve, por as të hedhim baltë për institucionet. Ka ca afate ligjore që të cilat do të respektohen nga palët për të marrë përgjigje secili sipas kërkesës që ka bërë në bazë të ligjit. Pastaj nëse nuk vijnë këto përgjigje ka institucione të tjera të pavarura shtetërore që merren me ankime eventuale që mund të kenë palët mbi moszbatimin e ligjit. Në këtë rast për Ligjin “Për të drejtën e informimit” nga këto institucione. Po zoti Logu.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti kryesues duke qenë dakord po themi ne nuk është se paraqesim kërkesa për informacion në cilësinë e provës. Neni 136 pika 1, germa “c”, parashikon si kusht procedural që kur bëhet një kërkesë për marrjen e provave të vërtetohet apo të faktohet nga pala që ka kryer vetë përpjekje për t’i marrë dhe kjo nuk ka qenë e mundur. Besojmë se institucionet publike që i kanë marrë kërkesat tona për informacion janë të vetëdijshme që afatet të cilat sepse ne e kemi

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.27.05.2021*


cituar që cili është qëllimi i këtyre kërkesave. Janë të vetdijshme që afatet në të cilat vepron Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve janë të shkurtra dhe në raste të caktuara dhe institucionet duhet t'i shërbenin një interes publik që ka të bëjë me garantimin e një procesi sa më të rregullt ligjor nëpërmjet një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të gjitha faktet dhe provat të paraqitura. Kështu që edhe për nevoja të këtij procesi ne kërkojmë që të depozitojmë në dosjen që po shyrtohet pranë jush kërkesat tona për informacion duke treguar faktuar që nga ana PD-AN janë kryer të gjitha përpjeket e nevojshme që kërkon ligji për t'i marrë vetë këto informacione në përputhje sigurisht me ligjin për të drejtën e informimit.

**Z. E. Lako:** Po zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Më shumë ndoshta për kurjozitet se çfarë mund t'i vlej analizës sonë po nga dijenia ime Prokuroria e Përgjithshme mban një informim të azhurnim periodikisht lidhur me procedimet në fushën e zgjedhjeve. Ju e keni konsultuar këtë azhurnim, ju vlen nuk ju vlen, ua plotëson kërkesën me raport me prokurorinë apo jo apo nuk keni parë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** E kemi parë zoti Rusmali për të shuar dhe kuriozitetin tuaj ne kemi ndjekur po themi azhurnim që ndodhen në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme por edhe deklaratat e Prokurorit të Përgjithshëm dhe në fakt jemi nxitur nga ato deklarata për t'i përsëritur kërkesat tona se vet Prokurori i Përgjithshëm ka thënë që hetimet kanë dhënë rezultatet e tyre, të cilat shumë shpejt do t'i bëhen të njohura publikut dhe duke qenë se për nevoja të këtij shqyrtimi administrativ këtë që po i bëhet kërkesave tona ankimore kemi vlerësuar se janë me dobi edhe për ne për të provuar fakte dhe pretendime që kemi ngritur. Kemi kërkuar

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

që këto rezultate të cilat Prokurori i Përgjithshëm thotë që i kemi, t'i marrim, t'i administrojmë në këtë proces për aq sa është e mundur dhe më pas të vlerësohet nga ana e këtij komisioni kështu që për t'u përgjigjur drejt për drejt pyetjes suaj po jemi shumë të vëmendshëm ndaj çdo informacioni që publikohet në regjistrat publikë të institucioneve shqiptare dhe ndaj çdo deklarate që bëhet nga drejtuesit e këtyre institucioneve.

**Z. I. Rusmali:** Mendoni me aq sa ju jeni ekspert i ligjit besoj keni njohuri në fushë me aq sa e njihni ju legjislacionin penal. Mendoni që prokuroria si institucion ose eventualisht Prokurori i Përgjithshëm, kanë detyrimin ndaj jush ose ndaj nesh që të referojnë përmbajtjen e dosjeve në hetim, jo dosjeve të mbyllura të pushuara, jo dosje të dërguara në gjykatë, po dosjeve në hetim ka detyrim të na e thotë, apo ka pengesë të na e thotë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ka dy gjëra pyetja juaj zoti Rusmali e para ne jemi kallëzuesit dhe sigurisht kallëzuesit në procedurën penale për të cilën po themi kemi njohuri të mjaftueshme ligjore secili këtu prej nesh kanë disa të drejta shtesë në raportet me palët e tjera, kjo e para. Megjithëse ne jemi kallëzues, të cilët kemi të drejtë gjatë procesit po themi të hetimit të bëjmë kërkesa procedurale për të kuptuar po themi cilat janë veprimet hetimore që janë kryer nga prokuroria, apo për të kryer kryerjen e veprimeve hetimore shtesë të cilat ne i vlerësojmë. Nga ana tjetër përveç kësaj që nuk na është thënë, pra ne i kemi kërkuar edhe Prokurorisë së Përgjithshme se çfarë ka ndodhur dhe Prokurorive të Juridiksonit të Përgjithshëm se çfarë ka ndodhur me kallëzimet tonë penale, sigurisht nuk na është vënë asnjë lloj informacioni. Thënë kjo e para, dhe sigurisht zoti Rusmali kjo që bëni ju po themi më duket dhe një përpjekje disi po themi jo shumë etike ndaj një personi që e njeh

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

ligjin. Ne e dimë konceptin e sekretit hetimor kështu që nuk ka nevojë po themi të mbajmë këtu leksionin njëri-tjetrit, po për sa kohë që...


**Z. I. Rusmali:** Unë nuk e di po pyes meqë e dini ju të na e thoni! Unë nuk kam dijeni për konceptin, nuk e njoh fare!

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Më lejoni t'iu bëj një leksion., meqënëse ju keni qenë profesor dhe mbas...

**Z. I. Rusmali:** Përgjigjuni pyetjes e mos bëni leksion, është shumë e thjeshtë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Gjithçka që përbën sekret hetimor ne nuk i kërkojmë Prokurorisë kundër korruptionit dhe krimit të organizuar të nxjerrë sekretin hetimor për nevojat e këtij procesi as Prokurorisë së Përgjithshme, po për sa kohë thuhet që hetimet janë bërë dhe janë përfunduar dhe shumë shpejt e të tjerë. Ne mendojmë që prokuroria dhe këtë duhet ta shohim, duhet ta marrim fillimisht si provë dhe që ta dijmë që prokuroria për raste të caktuara mund t'i ketë mbyllur hetimet dhe sigurisht kjo mbetet për t'u verifkuar nuk jemi më përpara sekretit hetimor se prokuroria mund të ketë mbyllur hetimet dhe mund të jetë në fazën që mund të na japë dijeni ose të na e vëré në dispozicion këto prova dhe këto fakte. Në qoftë se prokuroria është duke kryer hetime është një gjë që ata mund të na e thonë dhe pastaj ne do të vlerësojmë. Sigurisht kemi të drejtë edhe bazuar në Kodin e Procedurës Civile, por dhe në akte të tjera nënligjore që për hir të këtij procesi t'i kërkojmë edhe KAS-i të pezullojë po themi shqyrtimin e saj dhe të presë vendimmarrjet e organeve të tjera është kërkësë plotësisht e ligjshme në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Prokurori i Përgjithshëm referon në komunikimin publik në atë që e azhurnon në mënyrë periodike, referon për çështje penale të pushuara. Unë imagjinoj se kur pushohet një çështje domethënë subjekti që ka bërë kallëzimin i çohet njoftimi që është pushuar...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z.I.Rusmali:** ...çështja. Ju keni marrë njoftime për pushim çështjeje apo ndonjë kërkesë drejtar gjykatës për pushim çështjeje? Keni marrë të tilla? Se ka çështje që ai thotë, janë pushuar?

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Citimi është i gabuar zoti Rusmali. Prokurori i Përgjithshëm në deklaratën e tij ka thënë që: "Ne kemi kryer hetime për krimet zgjedhore, që janë referuar nga subjektet politike, apo për të cilat kemi marrë dijeni kryesisht, për të cilat kemi rezultate konkrete" nuk thotë pushim çështjeje, sigurisht nuk e përjashtojmë ...

**Z.I.Rusmali:** Atëherë, referencia ime është njoftimi publik në faqen e Prokurorisë së Përgjithshme.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Referencia ime është deklarata që është bërë përpara 3 ditësh, nga Prokurori i Përgjithshëm në Fier.

**Z.I.Rusmali:** Atëherë, nuk mund të thuash në qoftë se unë kam një referencë të ndryshme nga e jotja, nuk mund të thuash që referencia ime është gabim. Referencia ime është e ndryshme nga e jotja dhe në referencën që kam unë, që është e dhënë publike, është në faqen e internetit të Prokurorit të Përgjithshëm. Njoftimi i fundit flet dhe për çështje të pushuara dhe unë imagjinoj që çështjet e pushuara duhet t'ju involvojnë juve si palë medoemos, apo jo?

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord, zoti Rusmali! Ndërkohë që referencia që kam unë, i cili po ashtu është një fakt publik, ka të bëjë me një deklaratë zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili thotë që: "Kallëzimet që kanë bërë subjektet zgjedhore, apo për të cilat janë filluar hetimet, kryesisht kanë dhënë rezultate

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

konkrete për të cilat shumë shpejt ne do ndërmarrim hapa të caktuara” kështu me radhë, edhe kjo është një deklaratë publike e Prokurorit të Përgjithshëm, e cila mund të gjendet dhe të aksesohet lehtësisht *online* dhe sigurisht që këto rezultate që kanë dhënë hetimet, ne i kërkojmë këtij Komisioni që t'i marrë, të shohim se çfarë janë, etj, pa i paragjykuar. Për nga ana tjetër, lidhur me pushimin e çështjeve që ju thoni, ne deri më tani, nuk kemi dijeni, të jeni i bindur që sapo të kemi dijeni do veprojmë në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, për të gjitha të drejtat që na lejohen dhe na njihen. Por fillimisht zoti Rusmali, ju dhe Komisioni duhet të pranoni që të merrni këto prova dhe më pas t'i shihni, se nuk i paragjykojmë provat, pra ne themi, merrni provat, le t'i shqyrtojmë, le të zbardhet e vërteta siç është, mbase është ashtu siç thoni ju, mbase është ashtu siç themi ne, mbase është një gjë komplet e ndryshme.

**Z.I.Rusmali:** Unë nuk them asgjë, sepse unë nuk kam asnje dijeni për gjërat. Unë them atë që lexoj në njoftimin zyrtar, nga organi zyrtar. Asnjë gjë më shumë se kaq, por unë insistoj që të marr përgjigjen që më ngeli pa marrë. Ne si Komision, ne që jemi këtu, kemi në vlerësimin tuaj, të drejtën që të thyejmë sekretin vendimor?

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Rusmali, besoj që askush, as unë, as ndonjë përfaqësues tjetër i ndonjë subjekti politik, nuk ka kërkuar që të shkelet asnje lloj dispozite ligjore apo nënligjore. Sekreti hetimor është i shenjtë për Prokurorinë, është i shenjtë dhe për ne, por në rastet kur Prokuroria ka kryer hetime të mjaftueshme dhe më pas ka ndërmarrë veprime të tjera proceduriale dhe rezultate të cilat mund të na vihen në dispozicion, për këtë ne duhet të kërkojmë fillimisht informacion dhe duhet ta dimë, besoj që mund t'i shërbejmë edhe këtij procesi për

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

të vërtetuar ato pretendime që ne kemi ngritur. Ju thatë, nuk e dini, se sigurisht duhet të mbani një qëndrim të paanshëm, por në dijeninë tonë, ka fakte, prova, informacione dhe rezultate që kanë dhënë këto hetime, të cilat do të faktionin pretendime të ngritura nga ana e Partisë Demokratike dhe Aleancës për Ndryshim. Ne nuk kemi asnjë llojë kompleksi që t'i marrim këto prova, ftojmë edhe Komisionin, që të mos ketë asnjë lloj kompleksi për t'i marrë këto prova në përputhje me nenin 137, të Kodit Zgjedhor.

**Z.E.Lako:** Mua më duket tani sikur po zgjatemi tepër tek pjesa, t'ua lëmë organeve të akuzës punën e vetë!

**Z.L.Braho:** Doja të sqaroja diçka! Neni 110 i Kodit të Procedurës Penale të paktën për ato çështje që Partia Demokratike ka iniciuar kallëzim, jo për ato që prokuroritë e rretheve apo SPAK-u mund t'i ketë regjistruar kryesisht të paktën nen 110 thotë që: Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë në çdo gjendje dhe shkallë procedimi, të paraqesin memorien dhe kërkesa me shkrim, organi procedues shprehet me vendim brenda 15 ditëve. Pra, besoj që për çdo kërkesë ose memo që bën Partia Demokratike, organi procedues gjithmonë pa shkelur sekretin hetimor, se nuk besoj se Partia Demokratike do gjithë dosjen hetimore, gjithë fashikullin që ndodhi deri tani, të paktën ka detyrimin që për t'i sqaruar se në ç'fazë ndodhet dosja, a ka proceduar dikë apo jo? Pra këto janë elementet besoj, që do t'i vlenin dhe KAS-it, nuk na interesojnë elemente të tipit se, ana objektive, ana subjektive, në ç'fazë ka arritur hetimi dhe të gjithë hetimet proceduriale. Ky është një informacion që do t'i shërbente KAS-it, besoj për të gjitha ato kallëzime që Partia Demokratike ka bërë dhe që janë kërkesa që i ka bërë dhe vetë.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z.I.Rusmali:** Siç e kuptoju unë, këtë që ju thatë tani, më fal, por nuk është se kundërshtoj atë që tha kolegu Logu, siç e kuptoju unë këtë që ju thatë, leximi i referencës në Kodin Penal, do të thotë që ne, në fakt do të vepronim në drejtimin e kundërt, nuk duhet të ishte përfaqësuesi i PD-së që na kërkonte neve të marrim prova nga Prokuroria, por ne duhet t'i luteshim përfaqësuesit të PD-së, të na jepte ai provat nga Prokuroria, se mundësi tjetër përvçe palës, nuk ka, kështu e kuptova unë. Pala që është pjesë e procesit ka të drejtën që të bëjë kërkesa, të bëjë memo, të kérkojë informacione, etj. Ne si trup nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë tek hetimi, apo jo? Unë kështu e kuptova!

**Z.L.Braho:** Në fakt, kjo është njëra anë e mënyrës së të kuptuarit të këtij nenii, ana tjetër është që ta lidhim me nenin 137 të Kodit Zgjedhor, që na lejon dhe ne të bëjmë kërkesa kur këto kërkohen nga subjekti. Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Zgjedhor janë të dy ligje të miratuara me shumicë të cilësuar, qëndrojnë në të njëjtën hierarki.

**Z.I.Rusmali:** *Lex specialis!*

**Z.L.Braho:** *Lex specialis*, pikërisht se është *lex specialis*, ne këtu për zgjedhjet po gjykojmë.

**Z.E.Lako:** Do t'ju kérkoja që debatin dhe diskutimin ta përqendrojmë, se po i hyjmë një debati, një gjëje që, ne këtu jemi në hetim administrativ dhe nuk jemi as për të gjykuar punën e prokurorive as të drejtën e tyre...

**Z.L.Braho:** Edhe diçka tjetër! Për ta lënë, se besoj e sqaruam këtë pjesën e penales, pra janë të gjitha mundësitë, pavarësisht se kush zgjedh t'i pranojë apo

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

mos t'i pranojë, apo t'i shfrytëzojë këto mekanizma që ligji na njeh. Ndërkohë që, për gjithë kërkesat e tjera, sepse ato që iu kërkuan prokurorive janë vetëm një pjesë, pjesa tjetër pastaj, pjesa dërrmuese, janë kërkesa që i kërkohen institucioneve shtetërore. Është e vërtetë që janë bërë në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, është e vërtetë që ai ligj përcakton disa afate, por ky debat në lidhje me këto kërkesa ka më shumë se 20 ditë që bëhet tashmë publikisht dhe patjetër që të gjithë drejtuesit e këtyre institucioneve që u janë drejtuar këto kërkesa e kanë pasur mundësinë që, ose do ia kthenin Partisë Demokratike si kërkues ose t'ia sillnin KAS-it, duke qenë se këto do të shërbenin si materiale për KAS-in, por ka plot 20 ditë që askush nuk reagon. Kjo besoj është më shqetësuese në lidhje me transparencën, në lidhje me informimin publik, që institucionet shtetërore bëjnë, pjesa tjetër pastaj është, e gjykon historia besoj.

**Z.K.Bele:** Jo për debat, se nuk vlen që ne t'i provojmë njëri-tjetrit juristin, por kisha vetëm një gjë dhe kërkoj mirëkuptimin para teje zotit Braho, por bie dakord me atë që ligji për informimin publik dhe drejtuesit e institucioneve do bëjnë punën e tyre sipas kërkesës së kujdo qoftë, në këtë rast të Partisë Demokratike. Jam dyshues nëse ata do mund të kishin të drejtën, aq më pak detyrimin që t'ia drejtonin KAS-it ato kërkesa, jo vetëm që KAS-i nuk është investuar, por nuk mendoj, pra rikonfirmoj atë qëndrim të mbajtur dhe në ato vendime që kemi marrë deri tani, të ndërmjetme dhe përfundimtare, që nuk i takon KAS-it të bëjë kërkimet në institucione të treta për materiale, informacione, qofshin këto edhe prova, të cilat nuk i vlejnë procesit zgjedhor. Nëse një praktikë e tillë do stabilizohej gjatë këtyre shqyrtimeve gjyqësore, apo në raste të ngjashme, kurdo mund të ketë zgjedhje të natyrave të ndryshme, procesi zgjedhor do kthehej në një spirale, që i dihej fillimi, por do ishte e pamundur të identifikohej fundi. Ai afat 10 ditor që ka

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

vënë ligji dhe ato korniza që na vë Kodi Zgjedhor, jo domosdoshmërisht në termat e afatit mund të kapërcehet, për arsyet e arsyeshme, siç ishin në këtë rast, numri i madh i kérkesave, volumi, kérkesat e mëdha, prezantimet voluminoze të mirëkuptuara, por në fund të ditës ne kemi një kornizë, ne vlerësojmë çfarë ka ndodhur ditën e zgjedhjeve, në kuti dhe çfarë votash janë administruar. Ky është një qëndrim i mbajtur dhe me vendime dhe nuk dua që, nuk e kisha për debat, por kisha vetëm këtë, sepse duam, s'duam, këto seanca përveçse janë shqyrtimë administrative janë dhe seanca publike dhe nuk është qëllimi ynë të formojmë opinionin publik, por duam, s'duam ne, në ato që themi, ndikojmë dhe në mënyrën si opinioni publik e krijon procesin dhe drejtësisht pala ankuese ka shfrytëzuar kohë të madhe, maksimumet e veta për të parashtruar ato të drejta që ajo i mbron dhe është krijuar një lloj asimetrie, nëpërmjet paraqitjes në mënyrë të vazhdueshme të ca kérkesave dhe, po e quaj heshtjes publike të institucionit, mbasi ne nuk mund të bëjmë debat. Por, për ta përbledhur se dhe unë, duke dashur ta mbaja shkurt ndoshta u hallakata, e rikonfirmoj të paktën qëndrimin tim si anëtar i këtij institucioni, që nuk, as mundeshim t'i kérkonim dhe as minden institucionet kryesisht të na thonë “dëgjoni”, ose “ju informojmë juve trupën e KAS-it, se ne konstatojmë që kaq patenta”, apo cilado qofshin kérkesat, legalizime, se janë të shumta ato, kanë ndodhur. Nuk mendoj që jemi në natyrën e këtij procesi me gjithatë ky është qëndrimi im, nuk pretendoj që ta mendojmë të gjithë njësoj, dhe nuk e kisha as për debat.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Lako, një gjë të shkurtër!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z.E.Lako:** Atëherë do ju lutesha, që meqenëse jemi tek prapësimet që kanë palët mbi provat, i hymë një debati, të cilin ne si anëtarë nuk mund ta ushtrojmë këtu në prezencën tuaj, ne do tërhiqemi për të marrë vendim.

Diskutimin nuk do ta bëjmë bashkë zoti Logu, do ta bëjmë ne. Qendrimin tuaj e dimë, është bërë i njohur, e keni përsëritur në çdo seancë, janë të njëjtat shkresa, është e njëjta kërkesë që bëni dhe nuk besoj se, në qoftë se ka ndonjë gjë të re jeni i lirë.

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Meqenëse vijmë tek diskutimi që bëmë me zotin Rusmali, ka një njoftim në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, të datës 20 maj 2021, që thotë: "Janë regjistruar 47 procedime penale, për vepra penale që lidhen me zgjedhjen, 6 prej tyre janë përfunduar dhe janë vendosur 4 persona nën hetim deri në këtë fazë, nga ana tjetër thotë, po ndiqen penalisht për veprat penale në fushën e zgjedhjeve 11 persona, ndër të cilët 5 janë arrestuar në kushtet e flagrancës". Pra, edhe Prokuroria e Përgjithshme ka arritur disa rezultate konkrete siç njoftohen në datën 20 maj 2021, njoftim publik, të cilat ne vlerësojmë që i shërbejnë këtij procesi. Ne zoti Lako, vendimmarrja sigurisht është e juaja dhe ne e respektojmë deri në fund dhe do shfrytëzojmë çdo mjet procedural për ta kundërshtuar, po themi institucionet e tjera, por nuk duam që të ndodhë ajo që ka ndodhur në zgjedhjet e Dibrës në 2016-ën dhe në zgjedhjet e Durrësit në 2017-ën ku pavarësisht se u faktua për opinionin publik shqiptar dhe ndërkombëtar, që zgjedhjet ishin blerë masivisht, nuk ndodhi asgjë me rezultatin e atyre zgjedhjeve. Ne mendojmë që kemi të drejtë ta kërkojmë këtë gjë, sigurisht që vendimmarrja u takon anëtarëve të Komisionit.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

**Z.E.Lako:** Faleminderit zoti Logu! Këto informacione i shërbejnë publikut, ne e përgëzojmë Prokurorinë, në luftën e saj kundër krimit të çfarëdo lloji. Unë them që të fokusohemi tani tek objekti. Vazhdojmë me palët e interesuara, kanë ndonjë kërkesë, ndonjë prapësim lidhur me provat, me kërkesat e paraqitura?

**Z.M.Legisi, përfaqësues i PS-së:** Në lidhje me kërkesat për administrimin e provave ne vlerësojmë, zoti kryetar, se nuk është e mjaftueshme që në këtë proces të provohet fakti i pamundësisë së administritimit të këtyre provave nga vetë ankuesi, lidhur edhe me prapësimet tona që dhamë në fillim në lidhje me themelin e pretendimit.

**Z.E.Lako:** Të më falësh! Ajo është një kërkesë, një shpjegim që i bën ankuesi, ne si KAS jemi shprehur me vendim dhe i kemi përcaktuar në vendim të gjitha argumentet tona, nuk mund t'i themi tani sepse nuk jemi në debat. Por në vendim ne e kemi sqaruar vendimmarrjen tonë për të gjitha arsyet, njëra nga ato është një pikë e Kodit, pra ai është një pretendim që e ka ankuesi, nuk është vendimmarrja jonë, kështu që pretendimet mbi provat e paraqitura, çfarë argumentesh keni të lutem?

**Z.M.Legisi, përfaqësues i PS-së:** Jo, mbi provat e paraqitura nuk është se kemi argumente, por për faktin që, për kërkesën që KAS-i të angazhohet apo të investohet për të marrë prova, për të provuar themelin e pretendimeve, ne vlerësojmë që të mos pranohet si kërkim, pasi nuk argumentohet, vazhdon të mos argumentohet që nëse do administrohen atëherë, për cilën qendër votimi do të administrohen për të konstatuar pavlefshmërinë, pikërisht në atë qendër votimi. Për sa kohë ky arsyetim, apo argumentim vazhdon në këtë formë dhe në këtë

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

përbajtje, ne vlerësojmë që kërkimi është i pabazuar në lidhje me provat, të mos pranohet si kërkesë. Faleminderit!

**Z.E.Lako:** Faleminderit! Përfaqësuesit, nuk keni ndonjë koment? Atëherë KAS do tërhiqet për vendim të ndërmjetëm në lidhje me kërkesën për paraqitjen e provave për provat e reja. Po zoti Braho!

**Z.L.Braho:** Zoti Sekretar i Përgjithshëm, keni ndonjë informacion që, në qoftë se në eventualitetin e kërkimit të provës, që është kryqëzimi i të dhënave PEI, sa kohë mund t'i duhet administratës për ta përgatitur?

**Z.Y.Merkaj:** Sapo komunikova me personin përgjegjës, besoj për gjysmë ore është gati, përgjigjja për kryqëzimin e Elbasanit.

**Z.L.Braho:** Në rregull, faleminderit!


**Z.E.Lako:** Atëherë po tërhiqemi për vendim dhe do të vijmë shumë shpejt, për 10 minuta.

**Rifillon mbledhja**

**Ora 13:28**

**Z.E.Lako:** Atëherë KAS vendosi të administrojë provat ashtu siç janë paraqitur. Lidhur me kërkesën për marrjen e 19 provave të tjera, KAS vendosi me shumicë votash rrëzimin e saj, për shkaqe të cilat do të bëhen, do të arsyetohen, janë bërë të njohura, por do të arsyetohen me vendimin përfundimtar të tij dhe meqenëse dy

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.27.05.2021*

anëtarë të KAS-it, bazuar në nenin 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, kërkuant të administrohet si provë, të dhënat e kryqëzuara nga pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, për Qarkun Elbasan, për të bërë të mundur evidentimin e rasteve të votimit të dyfishtë dhe familjar sipas pikës 3, të nenit 136, kjo kërkesë nuk i nënshtrohet debatit, as votimit dhe KQZ-ja do t'i nxjerrë dhe do t'ua vëré në dispozicion palëve, 2 anëtarëve dhe pastaj palëve besoj. Kështu që, afersisht sa kohë duhet pér ta nxjerrë këtë si informacion zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z.Y.Merkaj:** Pér Elbasanin, pér 10 minuta e kemi gati.

**Z.E.Lako:** Atëherë në momentin që do ta keni këtë si provë, t'ua vëmë në dispozicion dy anëtarëve në mënyrë që të njihen dhe palët pjesëmarrëse me këtë dhe pér këtë arsyen ne do ta ndërpresim procesin këtu dhe pastaj në vijimësi dhe të kërkesave eventuale që mund të kenë palët pér t'u njohur, apo kohës që mund të kërkojmë. Në orën 15:00 do të rifillojmë seancën ose me vazhdimin e këtij qarku, në qoftë se do të jenë gati, ose vazhdojmë me ankimin e radhës që është Qarku Korçë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

